

KOSOVO POLICE

MBROJTËSI

Vëllimi X - Nr. 8 / 2018 ... drejtësi për të gjithë



POLICIA E KOSOVËS E GATSHME PËR INTERPOL



INTERPOL

KOMENTI I KRYEREDAKTORIT

Policia e Kosovës (PK), me 6 shtator të këtij viti, shënoi 19 vjetorin e themelimit të saj, ditë kjo e cila shënon një epokë të angazhimit dhe të përkushtimit ndaj sigurisë, paqes, stabilitetit dhe demokracisë në Republikën e Kosovës.

Policia e Kosovës gjatë rrugëtimit 19 vjeçar u ballafaqua me situata të ndryshme, të cilat arriti t'i menaxhojë dhe t'i tejkalojë me sukses, falë profesionalizmit dhe udhëheqjes së bazuar në parimet dhe standardet më të larta demokratike.

Për të arritur këto vlera PK-ja iu ka kushtuar rëndësi parimeve udhëzuese, si: trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, paanshmëria dhe neutraliteti, integriteti dhe transparencja, vlera këto të cilat e bëjnë Policinë e Kosovës si institucionin më të besuar dhe më transparent ndër policitë e Ballkanit perëndimor.

Gjatë këtyre viteve PK-ja ka qenë bartëse e shumë operacioneve të suksesshme të realizuara në partneritet me shumë agjenci homologe të rajonit dhe më gjerë.

Reflektimi i sukseseve të PK-së kalon edhe përtej kufijve të Kosovës, sepse sot PK-ja me punën, përkushtimin dhe profesionalizmin ndikon drejtpërsëdrejti jo vetëm në sigurinë e vendit tonë por edhe të rajonit dhe më gjerë.

Këtë e mbështesim në faktin se Republika e Kosovës vazhdon të mbetet lider në nivel rajonal, për sukseset dhe masat e ndërmarra në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të terrorizmit, ku një rol pozitiv në këtë drejtim ka pasur edhe Policia e Kosovës, e cila është ballafaquar drejtpërsëdrejti me raste të kësaj natyre të cilat kanë qenë mjaft sfiduese.

Sfidë tjetër nga aspekti policor vazhdon të mbetet çështja e ngritjes së profesionalizmit dhe e integritetit policor, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Si rezultat i mosanëtarësimit në mekanizmat rajonale dhe në ata ndërkombëtarë të sigurisë, siç janë: SELEC, INTERPOL etj., Policia e Kosovës ka hasur në vështirësi në menaxhimin e disa rasteve me karakter ndërkombëtar.

Megjithatë falë përkushtimit të institucioneve të Kosovës në fushën e sigurisë, e në veçanti të Policisë së Kosovës, shumë vende të rëndësishme kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të gjetur mënyra të bashkëpunimit, duke përfshirë edhe bashkëpunimin bilateral, bashkëpunim ky i cili po bëhet edhe përmes ILECU.

Referuar rezultateve të sigurisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit, të realizuar përmes ILEC, besojmë se këtë fund vit PK-ja do të anëtarësohet në INTERPOL.

Anëtarësimi i PK-së në mekanizma ndërkombëtarë do të ndikojë edhe më tej në ngritjen e sigurisë globale, që është interes edhe i Kosovës dhe i të gjitha shteteve rajonale dhe më gjerë.



Baki KELANI



Revistë e Policisë së Kosovës

Botues:

ZIMP

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie
me Publikun e PK-së
DPP - Prishtinë

Kryeredaktor:

Baki KELANI

Redaktor:

Daut HOXHA

Tel.: 038 5080 1243

Tel.: 038 5080 1237

Mob.: 044 506 308

Mob.: 044 181 418

E-mail:

baki.kelani@kosovopolice.com

daut.hoxha@kosovopolice.com

zimp@kosovopolice.com

Bashkëpunëtorë:

FADIL ABDYLI

MERITA CANOLLI-GASHI

DR. LINDITA KAJTAZI

BRAHIM SADRIU

Dizajni:

Çajup KAJTAZI

Lektor:

Leonora FEJZULLAHU - RUHANI

Fotograf:

Arbër MUHADRI

Telefon: 192

info@kosovopolice.com

www.kosovopolice.com

facebook.com/KosovoPolice

twitter.com/Kosovo_Police

PËRMBAJTJA

RASHIT QALAJ, DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, 4

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I PK-SË, Z. RASHIT QALAJ, PRITI NË TAKIM AMBASADORIN AMERIKAN GREG DELAWIE, 5
KOMANDANTI I KFOR-IT, GJENERAL SALVATORE CUOCI, VIZITON DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS, Z. RASHIT QALAJ, 6

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I PK-SË PJESËMARRËS NË KONFERENCËN E 125-TË TË ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR TË SHEFAVE TË POLICISË NË ORLADO TË SHBA-SË, 7
DREJTUESIT E ANTITERRORIT TË TRI SHTETEVE, KOSOVËS, ITALISË DHE SHQIPËRISË, MBAJTËN TAKIM ZYRTAR NË POLICINË E KOSOVËS, 8

PRIORITET I POLICISË SË KOSOVËS EDHE PARANDALIMI DHE LUFTIMI I TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE, 9

BASHKËPUNIMI NDËRORGANIZACIONAL NDËRKOMBËTAR PËR LUFTIMIN E KRIMINALITETIT QË TEJKALON KUFIJTË, 10-15
SHËNOHET 19 VJETORI I THEMELIMIT TË POLICISË SË KOSOVËS, 16-17

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT KIBERNETIK, 18-19
ROLI I ZYRËS SË MEDIAVE NË POLICINË E KOSOVËS, 20
GJËNDRA TIROIDE DHE ROLI I SAJ NË ORGANIZËM, 21
OPERACIONE, 22-23

INTEGRITETI, BAZË E NJË PUNE TË SUKSESSHME, 24

POLICIA E KOSOVËS PËRMES FAQES ZYRTARE UA MUNDËSON QYTETARËVE QASJEN PËR KONTROLLIMIN E TIKETAVE TË TRAFIKUT, 25

KURIOZITETE, 26-27

FOTOLAJM, 28

MË GJERËSISHT →

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medoemos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së.

RASHIT QALAJ, DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS

Në gusht 2018, Rashit QALAJ, emërohet drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në vendlindje në Ferizaj, për të vazhduar pastaj në Prishtinë me studime të larta ku u orientua kryesisht në menaxhment.

z. QALAJ përveç përkushtimit të vazhdueshëm në shërbim të qytetarëve dhe të vendit, para se të zgjidhet në postin e të parit të Policisë së shtetit, ka menaxhuar dhe ka udhëhequr drejtori dhe departamente mjaft të rëndësishme në kuadër të Policisë së Kosovës.

Sukseset e tij në menaxhimin dhe udhëheqjen e Departamentit të Operacioneve në Policinë e Kosovës nga 15 prill 2013, deri në zgjedhjen e tij si drejtor i Përgjithshëm, kanë qenë të vlerësuara lart, pasi që gjatë kësaj periudhe Republika e Kosovës ka kaluar nëpër procese mjaft të ndjeshme dhe planifikimi, organizimi dhe udhëheqja e personelit policor, në veçanti e njësisve operative dhe të specializuara gjatë menaxhimit të situatave të ndryshme shpeshherë kritike, kanë qenë në nivelin më të lartë profesional të kryerjes së detyrës pikërisht nën menaxhimin dhe udhëheqjen e z. QALAJ.

Përkushtimi, trajnimet e vazhdueshme si në nivel vendi dhe në nivel ndërkombëtar, përvoja dhe puna e palodhshme ofruan shansin që zotëri QALAJ të marrë timonin e organizatës policore me gjithë sfidat që e shoqëronin atë. Përpjekjet e tij të vazhdueshme bashkë me aktorët tjerë vendorë e ndërkombëtarë përfshijnë pranimin e Policisë së Kosovës në INTERPOL.

Disa nga trajnimet e kryera:

- Kursi për çështjet e reja të sigurisë 2006, Geneva Center for Security and Policy nga 19 prill 2006 – 05 korrik 2006
- Programi i studimit të gjuhëve për çështjet e sigurisë nga 16 prill deri më



11 maj në qendrën Marshall në Gjermani

- Programi për terrorizmin dhe studimet e sigurisë nga 12 shkurt – 19 mars 2010 në qendrën Marshall në Gjermani
- Kursi mbi sigurinë, stabilitetin, tranzicionin dhe rindërtimin nga 21 qershor – 8 korrik 2011 në qendrën Marshall në Gjermani
- Trajnimi mbi çështjet e hetimit në Vjenë – Austri
- Shkolla ndërkombëtare e stafit policor dhe komandës policore – Universiteti Northwestern Qendra për Siguri Publike 10 shtator – 30 nëntor 2012
- Moduli i avancuar i shkollës për integritet evropiane, 22 shkurt - 26 maj, 2013
- Kursi mbi menaxhimin e mbrojtjes në kontekstin më të gjerë të sigurisë – Akademia e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar dhe Universiteti i Cranfieldit nga 16 marsi – 1 maj 2015
- Programi i Lidershitit strategjik Akademia e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar dhe Universiteti i Cranfieldit, nëntor 2015

• Kursi mbi ndërtimin e bazave të integritetit 'Akademia e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar' dhe Transparency International për mbrojtje dhe siguri, 29 shkurt - 4 mars 2016

• Trajnimi në sigurimin e aktiviteteve dhe samiteve ndërkombëtare, Akademia Policore Turke, nëntor 2017 etj.

Eksperienca profesionale

- 22 maj 2000: fillimi i trajnimit bazik në Akademi Policore në Vushtrri
- 17 qershor 2000: fillimi i punës në Stacionin Policor të Lipjanit

- 30 maj 2002: gradimi në gradën e rreshterit
- 27 qershor 2003: gradimi në gradën e togerit
- 17 janar 2005: gradimi në gradën e kapitenit
- 7 mars 2005: komandant stacioni – Ferizaj
- 2 maj 2005: shef i Operativës Rajonale – DRP Ferizaj
- 25 janar 2006: gradimi në gradën e majorit.
- 10 mars 2008: u.d. zëvendësdrejtor rajonal për Operativë – DRP Ferizaj
- 22 tetor 2009: zëvendësdrejtor rajonal për Operativë – DRP Ferizaj
- 1 shkurt 2010 u.d. drejtorit rajonal – DRP Ferizaj
- 18 tetor 2011 u.d. drejtorit rajonal – DRP Prishtinë
- 26 qershor 2012 drejtor rajonal - DRP Prishtinë
- 15 mars 2013 promovim në gradën e nënkolonelit
- 15 prill 2013 drejtor i Departamentit për Operacione - DPP Prishtinë.

Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Rashit Qalaj, priti në takim ambasadorin amerikan Greg Delawie

Me 13.09.2018 në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ambasadori amerikan, z. Greg Delawie, së bashku me zyrtarë të lartë të ICITAP-it, u takuan me drejtorin e Përgjithshëm të PK-së z. Rashit Qalaj, i cili ishte i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij.

Drejtori z. Qalaj në shenjë mirënjohje për bashkëpunimin e ndërsjellë, e falënderoi ambasadorin Delawie për vizitën e tij dhe njëkohësisht e njoftoi për angazhimet e PK-së dhe synimet drejt përmbushjes së detyrave dhe obligimeve të saja ligjore, në të mirë të sigurisë dhe rendit në Republikën e Kosovës.

Gjatë takimit ndër të tjera drejtori Qalaj potencoi se Policia e Kosovës është mirë e përgatitur dhe e angazhuar në ofrimin e sigurisë në vend dhe në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe njëkohësisht veçoi se do të vazhdohet me rritjen e profesionalizmit dhe të integritetit të Policisë së Kosovës.



Me këtë rast ambasadori Delawie e përgëzoi drejtorin Qalaj për përzgjedhjen e tij në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, duke i uruar suksese në punën e tij dhe njëkohë-

sisht z. Delawie konfirmoi mbështetjen e mëtutjeshme të Ambasadës Amerikane për Policinë e Kosovës, në fusha të ndryshme, e në veçanti në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë





Komandanti i KFOR-it, gjeneral Salvatore CUOCI, viziton drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Rashit QALAJ

Me 4 shtator 2018, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (PK-së), z. Rashit QALAJ, i shoqëruar nga stafi i lartë i tij, ka prituri në takim zyrtar gjeneralin e KFOR-it, z. Salvatore CUOCI. Drejtori QALAJ në shenjë mirënjohje për bashkëpunimin e ndërsjellë, e falënderoi gjeneral Salvatore CUOCI për vizitën e tij dhe njëkohësisht e njoftoi për angazhimet e PK-së dhe synimet drejt përmbushjes së detyrave dhe obligimeve të saja ligjore, në të mirë të sigurisë dhe rendit në Republikën e Kosovës.

Policia e Kosovës ka kapacitete profesionale dhe është e përgatitur që të ofrojë siguri, të luftojë kundër krimit të organizuar, krimit trans kufitar, si dhe të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, dhe si rezultat i nevojës së angazhimit, bashkëpunimit dhe inkuadrimin të Policisë së Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë.

U veçua se Policia e Kosovës ka bashkëpunim të mirë me autoritet e KFOR-it, bashkëpunim ky i cili ka treguar rezultate pozitive në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe

sukseset në patrullimet e përbashkëta, kryesisht në brezin kufitar. Gjatë takimit u zotua për bashkëpunim të ndërsjellë edhe në të ardhmen, duke përfshirë edhe shkëmbimin e

përvojave dhe trajnimeve fushore, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të dy institucioneve, e që kanë synime të përbashkëta në sigurinë e vendit dhe të qytetarëve.



Drejtori i Përgjithshëm i PK-së pjesëmarrës në konferencën e 125-të të Asociacionit Ndërkombëtar të Shefave të Policisë në Orlado të SHBA-së

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Rashit QALAJ, ka qëndruar në Orlando të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në një vizitë zyrtare, ku ishte pjesëmarrës në konferencën e 125-të IACP-së (International Association of Chiefs of Police - Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë).

Në këtë konferencë, ku pjesëmarrës ishin një numër i madh i nivelit të lartë të shefave të Policisë nga vende të ndryshme të botës, me një fjalë rasti të pranishmëve iu ishte drejtuar edhe Presidenti i SHBA-ve, z. Donald TRUMP, i cili ndër të tjera kishte potencuar nevojën e bashkëpunimit global dhe mbështetjen e shteteve në misionin e përbashkët për një botë më të qetë dhe më të sigurt.

Kjo konferencë e karakterit ndërkombëtar mundëson shkëmbimin e përvojave policore, trajtimin e problemeve dhe fenomeneve nga fusha e rendit dhe sigurisë, si dhe njohjen me teknologjitë më të reja të cilat aplikohen në fushën e sigurisë.

Drejtori QALAJ përveç tjerash rëndësi primare i kushtoi çështjes së bashkëpunimit policor ndërkombëtar, me theks të veçantë anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Për këtë qëllim janë mbajtur dhjetëra takime me



përfaqësues të shteteve nga mbarë bota, përderisa mori pjesë në sesione të ndryshme që ndërlidheshin me temat më të rëndësishme, si: reforma policore përmes menaxhimit të të dhënave,

integrimi i një kornize etike në kulturën e organizatave policore, marrëdhëniet me media në shekullin 21, shefat ekzekutivë të policisë sot, shefat femra të policisë ripërcaktojnë lidhshëpinë si kurrë më parë etj.

Po ashtu në këtë konferencë fokus i veçantë i është dhënë luftës kundër terrorizmit dhe radikalizmit

të dhunshëm, krimin të organizuar transnacional si dhe llojeve të tjera të krimin.

Drejtori QALAJ gjithashtu mori pjesë në ekspozitën e pajisjeve të ndryshme policore, me qëllim të avancimit të pajisjes së PK-së me pajisje moderne teknologjike, në përputhje me zhvillimet globale.

Kjo konferencë e karakterit policor është një nga konferencat më të mëdha që mbahet çdo vit në SHBA, ku Policia e Kosovës është mbështetur dhe është përkrahur nga ICITAP-i amerikan për të qenë pjesëmarrës.





Drejtuesit e Antiterrorit të tri shteteve, Kosovës, Italisë dhe Shqipërisë, mbajtën takim zyrtar në Policinë e Kosovës

Me 19 shtator 2018 në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës (PK-së), Drejtoria Kundër Terrorizmit e PK-së ishte nikoqire e takimit trepalësh, ndërmjet drejtorive kundër terrorizmit të Policisë Italiane dhe Policisë Shqiptare. Ky takim vjen si rezultat i takimeve të mëhershme të realizuara në Itali dhe në Shqipëri, në kuadër të vlerësimit të kërcënimeve aktuale dhe vazhdimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të tri organizatave policore.

Takimin e përshëndeti edhe drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. Rashit QALAJ, i cili ndër të tjera tha: "Duke marrë parasysh që terrorizmi si fenomen ka një shtrirje mjaft të gjerë, duke tejkaluar edhe kufijtë nacionalë, apo edhe rajonalë, asnjë vend si i vetëm nuk mund të jetë i suksesshëm në parandalimin dhe luftimin e terror-

izmit. E vetmja mënyrë që garanton suksese në këtë aspekt është bashkëpunimi dhe shkëmbimi me kohë i informacioneve, andaj edhe ne si Polici e Kosovës e vlerësojmë shumë lart këtë iniciativë të bashkëpunimit trepalësh, në mes të Policisë së Kosovës, Policisë Italiane dhe Policisë Shqiptare, që padyshim është e rëndësishë së veçantë për sigurinë e të gjitha vendeve tona, por edhe kontribuues në sigurinë rajonale, por edhe në atë globale". Drejtori Qalaj

në fund theksoi se bashkëpunimi në kuadër të këtij grupi, por edhe formave tjera të bashkëpunimit do të ketë përkrahjen e plotë të Policisë së Kosovës si partner i rëndësishëm në sigurinë rajonale e atë globale dhe do të hapë rrugë në rrugëtimin drejt anëtarësimit të plotë në mekanizma ndërkombëtarë të sigurisë. Ndër të tjera z. Qalaj kërkoi mbështetjen dhe përkrahjen e institucioneve përfaqësuese në përpjekjet për anëtarësim të PK-së në INTERPOL, gjatë asamblesë

së përgjithshme në nëntor të këtij viti. Gjatë takimit, të pranishmit u zotuan për bashkëpunim të ndërsjellë dhe përkushtim drejt avancimit në shkëmbimin e informacioneve dhe mbështetjen ndërmjet partnerëve, me interesa të përbashkëta në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie.



PRIORITET I POLICISË SË KOSOVËS EDHE PARANDALIMI DHE LUFTIMI I TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE

Një nga detyrat dhe autorizimet e përgjithshme që dalin nga Ligji për Policinë është edhe parandalimi, hetimi dhe zbulimi i veprave penale, ku përfshihet edhe luftimi i trafikimit me njerëz.

Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore ka ndërmarrë dhe po ndërmerr në vazhdimësi masa të rëndësishme në identifikimin viktimave të trafikimit si dhe luftimin e kësaj dukurie, dhe në këtë fushëveprim janë realizuar edhe një numër i operacioneve policore të cilat kanë pasur për qëllim arritjen e objektivave të parapara.

Policia e Kosovës në vazhdimësi ka treguar gadishmëri për një bashkëpunim me shtetet e rajonit dhe më gjerë dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi me ato kompetenca ligjore që ka, janë realizuar edhe operacione të përbashkëta policore në nivel rajonal dhe janë shënuar edhe rezultate konkrete në arrestimin e personave të dyshuar dhe shkatërrimin e grupeve të ndryshme kriminale.

Ndërsa, është më se e rëndësishme të potencohet se anëtarësimi i Policisë së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë, si: INTERPOL-i, EUROPOL-i etj. do të jepte rezultate edhe më të mira në funksion të luftimit të krimit të organizuar në përgjithësi dhe trafikimit me qenie njerëzore në veçanti dhe do të eliminonte çdo barrierë që ndikon në luftimin e këtyre dukurive të dëmshme



të cilat tejkalojnë kufijtë vendorë...

Në funksion të vetëdijesimit lidhur me parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore me 18 tetor 2018 në ditën evropiane kundër trafikimit me njerëz ka filluar fushata vetëdijesuese që do zgjasë një (1) muaj.

Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, në partneritet me ICITAP-in amerikan dhe IOM ka bërë shtypjen e kartelave me indikatorë/ tregues të hershëm të identifikimit të viktimave të trafikimit. Pranimi i këtyre kartelave është bërë nga drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Rashit Qalaj i cili edhe ka mbajtur fjalim në hapjen e kësaj kampanje që është mbajtur në objektin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku ka paraqitur trendin e trafikimit, angazhimin e PK-së, shifrat statistikore, rezultatet dhe përkushtimin e PK-së në prandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie.

Kartelat janë fokusuar në trendet/ problematikat aktuale në Kosovë: shfrytëzim seksual i viktimave të trafikimit, shfrytëzimi i viktimave për punë të detyruar dhe shfrytëzim për kërkim lëmsh, si dhe indikatorët

për identifikim të viktimave në pikat kufitare.

Këto kartela do të shpërndahen tek të gjithë zyrtarët policorë e në veçanti në pikat kufitare si material informues / parandalues, përkatësisht do të bëhet shpërndarja edhe në komunitetet, ku problemi i trafikimit/keqpërdorimit të viktimave ka tendencë të jetë më i shfaqur.

Në kuadër të kësaj fushate, në përkrahje të ICITAP-it dhe INL-së është duke u punuar në përmirësimin e kushteve teknike në dhomat e intervistimit (dhomave miqësore) të viktimave të trafikimit në 5 rajone të PK-së. Dhomat e intervistimit janë duke u pajisur me kamera të montuara dhe mobile, që do të plotësojë një standard për trajtim të viktimave të trafikimit.

Po ashtu në partneritet me OSBE-në janë hartuar dhe janë shtypur edhe doracakë njoftues me indikatorë, se si të mbrohemi nga trafikimi, të cilët iu dedikohen studentëve dhe grupeve tjera gjatë debateve dhe tryezave që do të mbahen gjatë fushatës një mujore.

DHTQNJ në bashkëpunim me FRONTEX dhe projekti IPA II ka në proces realizimin dhe trajnimin për hetimin e trafikimit me njerëz, ku pjesmarrës janë zyrtarë të Policisë Kufitare të PK-së.

Të gjitha këto aktivitete bëhen për të ngritur vetëdijen e popullatës dhe grupeve të cënueshme në parandalim dhe rritjen e referimit të rasteve kur dyshohet se dikush po shfrytëzohet.

BASHKËPUNIMI NDËRORGANIZIM LUFTIMIN E KRIMINALITETIT

Policia e Kosovës përmes Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Zbatimit të Ligjit (ILECU - International Law Enforcement Cooperation Unit) ka realizuar aktivitetet të rëndësishme, ka bërë shkëmbim ndërkombëtar të informacioneve për raste të ndryshme kriminale, janë kryer hetime dhe operacione të përbashkëta në funksion të identifikimit dhe të arrestimit të personave të dyshuar të involvuar në aktivitetet kriminale që tejkalojnë kufijtë shtetërorë.

Në aspektin praktik të angazhimeve dhe të bashkëpunimit aktiv, gjatë vitit 2016 deri në vitin 2017, përfshirë edhe tre mujin e parë të vitit 2018, janë evidentuar këto raste:

Vitet	Rastet
2016	3799
2017	3318
Tremujori i parë 2018	1250

Policia e Kosovës përmes ILECU ka realizuar një bashkëpunim të mirë operacional ndërkombëtar edhe në rastet e krimeve të profilit të lartë, kundër krimit të organizuar dhe kundër krimeve të rënda.

Për periudhën kohore si në tabelën poshtë mund të gjeni statistikën.

BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR OPER.	2016	2017	2018
Informata	138	298	35
Takime operationale	20	23	-
Hetime të përbashkëta	11	11	03
Operacione të përbashkëta	03	02	01

ACIONAL NDËRKOMBËTAR PËR TIT QË TEJKALON KUFIJTË

Operacioni policor "GOLD"

Rasti "GOLD" është iniciuar me 23.02.2016 me autorizim të Prokurorisë Speciale të Kosovës, nën dyshimin për kontrabandim të mallrave, shmangie nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore, krimi organizuar dhe shpëlarje të parave. Bashkëpunimi është zhvilluar në mes të autoriteteve të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Malit të Zi, ndërsa me 08.09.2016 është zhvilluar operacioni "GOLD" në shtatë rajone, me ç'rast janë arrestuar 8 persona të dyshuar dhe janë kontrolluar 50 lokacione të ndryshme. Lidhur me rastin janë konfiskuar 26 kilogramë ari, 33 kilogramë argjend, 4.900 euro, tri vetura, një autobus si dhe dokumentacion relevant për rastin. Në vazhdim të operacionit me 09.09.2016 janë kontrolluar 2 lokacione në Prizren, me atë rast janë sekuestruar edhe: 2.356.37 gramë ari dhe 1.800 euro.

Bashkëpunimi me EUROPOL-in sjell rezultate në luftimin e kontrabandimit me migrantë

Rasti i koduar "KAPO" ka filluar pas informatave të marra në një takim operacional në HAGË me datën 09.03.2016. Rasti është iniciuar me 06.04.2016 duke u bazuar në informatat nga autoritetet policore të Hungarisë dhe të Austrisë. Përmes zyrës së ILECU është kërkuar që të organizohet takim operacional me pjesëmarrje të shteteve në të cilat ka pistë të hetimit. Është mbajtur takim operacional në lidhje me rastin me 12.07.2016, ku pjesëmarrës kanë qenë përfaqësuesit e Hungarisë, Austrisë, Sllovenisë, Kroacisë, Italisë dhe EUROPOL-it. Po ashtu informata janë shkëmbyer edhe me EUROPOL-in lidhur me koordinimin e veprimeve operacionale. Operacioni është realizuar me 27.10.2016 nën dyshimin për kontrabandën me

migrantë. Ky operacion policor është realizuar në rajonet e Pejës, Gjakovës dhe Gjilanit, ku ka qenë pjesëmarrës një zyrtar me pajisje mobile verifikuese nga EUROPOL-i.

Operacioni ka rezultuar me arrestimin e 6 personave dhe konfiskimin: 4 vetura, 12 telefona, 15 sim kartela, 2 USB, 6600 €, 30 CHF, 1780 SRD, 1 revole, 1 karikator, 2 granata dore, 82 fishekë me kalibra të ndryshëm, 2 komplete për pastrimin e armëve.

Operacioni policor "EUROMETAL"

Rasti i koduar "EUROMETAL" është iniciuar me datën 21.01.2016. Rasti ka të bëjë me një kompani biznesi në Kosovë e cila është mashtruar duke iu ndryshuar fatura dhe xhirollogaria nga persona të dyshuar, ku transaksioni i mjeteve në vlerë prej 5,000.00 eurove është realizuar. Kërkesë nga ILECU i është drejtuar për asistencë ndërkombëtare autoriteteve të Anglisë, Sllovakisë dhe Maqedonisë.

Kemi pranuar përgjigje nga autoritetet sllovaqe. Sipas tyre paratë në vlerë prej 4,983.00 € (katërmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tri) euro janë konfiskuar dhe ato të dërgohen tek kompania apo tek personat e autorizuar.

Është bërë ri-kërkesë drejtuar autoriteteve sllovaqe përmes ILECU për informata shtesë në lidhje me personat e dyshimtë. Kemi pranuar përmes ILECU të dhëna nga shteti i Sllovakisë, referuar kësaj dhe në konsultim me prokurorin, me datën 11.07.2016 është bërë kallëzim penal kundër dy personave shtetas të Sllovakisë.

Operacioni policor "RAFI"

Rasti i koduar "RAFI" është iniciuar me datën 09.08.2016. Rasti ka të bëjë me një kompani biznesi në Kosovë e cila është mashtruar duke iu ndryshuar

fatura dhe xhirollogaria nga persona të dyshuar, është bërë transaksioni i mjeteve në vlerë prej 12,500.00 eurove. Është bërë kërkesa për të dhëna relevante përmes ILECU drejtuar autoriteteve turke, suedeze, çeke dhe sllovaqe. Është pranuar përgjigje nga autoritetet suedeze për të dhëna shtesë të cilat janë kërkuar. Përkundër veprimeve që janë ndërmarrë, me qëllim identifikimin e personave të dyshuar, ka qenë i pamundur identifikimi i tyre. Nga autoritetet çeke kemi pranuar të dhëna lidhur me një person të dyshuar, referuar kësaj i jemi drejtuar Suedisë për konfirmim nëse personi është shtetas i Suedisë, ku është konfirmuar. Në konsultim me prokurorin, me datën 19.12.2016 është bërë kallëzim penal kundër një personi dhe i njëjti është dërguar në prokurori.

Operacioni policor "BEAUTY"

Rasti i koduar "BEAUTY" është iniciuar me datën 29.08.2016. Rasti ka të bëjë me një kompani biznesi në Kosovë, e cila është mashtruar duke iu ndryshuar fatura dhe xhirollogaria nga persona të dyshuar, është bërë transaksioni i mjeteve në vlerë prej 21,246.40 eurove. Janë bërë kërkesa përmes ILECU tek autoritetet e ShBA-së dhe Kroacisë.

Nga autoritetet kroate kemi pranuar të dhëna lidhur me dy persona të dyshuar të përfshirë në këtë rast, ku në konsultim me prokurorin me datën 15.11.2016 është bërë kallëzim penal kundër dy personave.

Operacioni policor "VATANI"

Rasti i koduar "VATANI" është hapur me datën 20.10.2016. Si pasojë e hyrjes në sisteme kompjuterike dhe mashtrim, ankuesi i rastit ka bërë një pagesë në vlerë prej 35,680.51 €. Përmes ILECU është bërë kërkesë tek autoritetet

suedeze, çeke dhe slloake, për ofrimin e të dhëna në lidhje me rastin. Nga autoritetet e Sllovakisë kemi pranuar të dhëna lidhur me një person të përfshirë në rast. Në konsultim me prokurorin, me datën 30.05.2017 është bërë kallëzim penal ndaj një të dyshuari shtetas i Sllovakisë.

Operacioni "AIR 2" gjen në Kosovë pajisjet elektronike të vjedhura në një shkollë të Suedisë

Rasti i koduar "AIR 2" është iniciuar pas pranimi të informatës nga Sektori për Hetimin e Krimeve Kibernetike përmes ILECU me datën 10.02.2017, me kërkesën e drejtuar nga autoritetet policore suedeze. Sipas kërkesës, autoritetet policore suedeze kanë kërkuar që t'ju asistojmë në gjetjen e disa pajisjeve elektronike (Laptop, iPad, telefona) të cilët janë vjedhur në një shkollë në Suedi me datën 17.01.2017. Sipas të dhënave të pranuar nga autoritetet policore suedeze, IP adresat e përdorura janë nga Kosova.

Në total janë sekuestruar tetë (8) iPad, që të gjithë janë verifikuar dhe kanë dalë se janë në listën që e kemi pranuar nga autoritetet suedeze.

Me datën 31.03.2017, pas lëshimit të urdhërës nga gjykata, tetë (8) iPad i janë dorëzuar, në zyrën e ILECU, atashut policor për vendet nordike në Kosovë.

Bashkëpunimi përmes operacionit "SKIMER" identifikon të dyshuarit që vendosnin pajisje elektronike (skimming) në bankomatët (ATM) e një banke në Republikën e Kosovës

Rasti i koduar "SKIMER" është iniciuar me datën 12.07.2017 nën dyshimin që ka të bëjë me pajisje të modifikuara për klonim të kartelave bankare. Pajisjet e modifikuara janë vendosur në bankomat (ATM) të bankës. Është bërë kërkesë përmes ILECU, ku disa video dhe fotografi u janë përcjellë të gjitha shteteve për identifikimin e personave të cilët dyshohet se kanë vendosur pajisje elektronike (skimming) në bankomatët (ATM) e një banke në Republikën e Kosovës.



Integrated

The Kosovo Police was established in 1999

The Law Enforcement Agency is comprised of 8,700 trained police professionals representing all ethnic groups. Women and minority groups can be found across all ranks and hold senior leadership positions.

The Kosovo Police has benefited from almost two decades of International Police Training and Development expertise from UN, OSCE, and EU missions resulting in a professional, committed, transparent, and ethical law enforcement agency in the service of all the people of Kosovo.



Capable

The Kosovo Police has successfully demonstrated its ability to contribute to International Law Enforcement Cooperation



Kosovo in INTERPOL

Kosovo Police Membership in INTERPOL increases the successful fight against transnational crime, including:

- Organized Crime
- Drug Trafficking
- Human Trafficking and Smuggling
- Cybercrime
- Corruption
- Financial Crime
- War Crimes
- Terrorism and Violent Extremism
- Weapons Trafficking
- Trafficking of counterfeit goods
- Vehicle Theft

CASE 1 2018



A cybercrime network spanning 50 countries was dismantled with the assistance of the Kosovo Police investigations and the execution of simultaneous global cyber fraud arrest operations.

CASE 2 2018



Kosovo Police participated in a regional joint law enforcement operation, resulting in the arrest of 78 migrant-smuggling-network suspects.

CASE 3



In cooperation with German and Belgian police, Kosovo Police helped prevent early stage plots in Kosovo and other countries, resulting in the arrest of six individuals.

www.kosovopolice.com/en
www.facebook.com/KosovoPolice
www.twitter.com/Kosovo_Police

Vote YES in Dubai

87th INTERPOL General Assembly

INTERPOL General Assembly
November 18-21, 2018
Dubai, UAE

Është bërë kërkesë përmes ILECU drejtuar autoriteteve bullgare për ofrimin e informatave në lidhje me disa persona shtetas bullgarë dhe shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët dyshohen se kanë të bëjnë me rastin.

Pas grumbullimit të dëshmimeve në lidhje me rastin, me datën 21.12.2017 është ngritur kallëzim penal ndaj tre (3) personave shtetas bullgarë dhe i njëjti është dërguar në prokurori.

Operacioni policor "ELEKTRONIKA" për luftimin e keqpërdorimit të kartelave bankare

Rasti i koduar "ELEKTRONIKA" është iniciuar me datën 13.11.2017 pas pranimi të informatave përmes ILECU nga autoritetet sllovene lidhur me keqpërdorimin e kartelave bankare të një ankuesi nga Sllovenia. Me datën 14.11.2017 janë arrestuar dy persona të dyshuar (njëri i mitur), janë marrë në pyetje dhe pas konsultimit me prokurorin janë liruar në procedurë rregullt. Në cilësi të provave janë sekuestruar dy kompjuterë laptop dhe dy telefona mobilë.

Me datën 16.11.2017 është bërë kallëzim penal kundër dy personave të dyshuar.

"INFRAUD" realizohet me kërkesë të SHBA-së për ndihmë juridike ndërkombëtare

Rasti i koduar "INFRAUD" është iniciuar me datën 06.02.2018. Janë arrestuar 2 persona të dyshuar, janë sekuestruar pajisje kompjuterike si dhe gjësende të ndryshme përfshirë 2 vetura. Sa i përket aktivitetit kriminal, referuar kërkesës së SHBA-së për ndihmë juridike ndërkombëtare, personat e dyshuar në vazhdimësi kanë kryer vepra penale, sipas Kodit të SHBA-së:

- Konspiracion për t'u angazhuar në organizatë kriminale të ndikuar nga reketimi (1962);

- Mashtim dhe veprimtari lidhur me pajisjet e qasjes (1029).

Me fjalë tjera, dy personat e dyshuar nga Kosova kanë qenë pjesë e një organizate të sofistikuar kibernetike kriminale e cila kryesisht merrej me trafikimin e kredit dhe debit kartave të komprometuara. Dy të dyshuarit kanë arritur të marrin dhe të përcjellin qindra karta krediti të komprometuara nëpërmjet rrjetit kriminal. Kanë përdorur pajisje elektronike si dhe adresa të shumëfishta elektronike për të komunikuar me anëtarët e tjerë të rrjetit kriminal dhe kanë përdorur të dhëna të kredit dhe

Why should Kosovo be a Member?

INTERPOL membership ensures that the Kosovo Police quickly and directly contribute to INTERPOL's information hub, fill key information gaps, participate in successful law enforcement tactical and operational activities and contribute to/benefit from global and regional policing capabilities essential to identify, investigate and take law enforcement actions against the range of transnational domestic, regional and international crime.

Does Kosovo meet INTERPOL membership requirements?

Kosovo meets INTERPOL membership criteria approved in the 2017 General Assembly. Kosovo has a territory; a population; a government and capacity to enter into relations with other states. Kosovo is signatory to over 100 of International Agreements and is a member of over 60 International Organizations. Kosovo has appropriate governmental authority pursuant to INTERPOL Constitution Article 4. The Kosovo Police is the official police body whose functions fall under the activities framework and has a unified chain of command. The Kosovo Police also has an International Law Enforcement Cooperation Directorate that would serve as the National Central Bureau (NCB).

What about UNMIK?

For over a decade, UNMIK has not exercised rule of law sector mandate or operational responsibilities in Kosovo. While UNMIK, OSCE, EU and other international partners contributed to establishing, training, monitoring and mentoring the Kosovo Police, policing in Kosovo is the exclusive mandate of its legally established law enforcement agencies.



Kosovo Police:
Ready to Contribute

A Message from the Kosovo Police General Director

The Kosovo Police is built on principles of credible, professional, democratic, policing and inclusive multi-ethnic representation underpinning the trust of all the communities it serves. We are committed to the protection of human rights and freedoms in full compliance with international standards. The Kosovo Police was established, trained, monitored, mentored, and advised by international police experts from around the world through the UN, the OSCE, the EU and bi-lateral partners over the course of close to two decades.

The Kosovo Police ensures local level safety and security while contributing to regional and international security. Trained, prepared and professional police efforts focus on fighting transnational organized crime, terrorism and violent extremism, trafficking, narcotics, serious crimes, and cybercrime, among others.

In recent years, the Kosovo Police has faced the emergence of complex international threats seen across the globe. These threats require coordinated regional and global responses. In order to meet these challenges, Kosovo has entered into over 75 bi-lateral and multi-lateral police cooperation agreements, including agreements with EU Agencies such as FRONTEX, OLAF, and CEPOL. However, in order to fully contribute to and considerably impact regional and international security, the Kosovo Police must become an INTERPOL member.

We believe that all INTERPOL members truly committed to connecting police for a safer world—to prevent and fight crime through enhanced cooperation and innovation on police and security matters will—fully support making the Kosovo Police an INTERPOL member.

debit kartave të komprometuara për blerje.

Në këtë rast kanë qenë të përfshirë persona tjerë nga vende të ndryshme të botës. Një operacion ndërkombëtar, përfshirë Kosovën, është zhvilluar me 6 shkurt 2018.

Lidhur me këtë operacion është publikuar edhe lajmi nga Departamenti i Drejtësisë – ShBA: <https://www.justice.gov/opa/pr/thirty-six-defendants-indicted-alleged-roles-transnational-criminal-organization-responsible>.

Operacioni “BALLKANI 2014” përmes bashkëpunimit në mes të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Serbisë, Bullgarisë, Turqisë dhe Italisë mundësojnë arrestimin e 36 personave

Rasti i koduar “BALLKANI 2014” është iniciuar në qershor të vitit 2015 dhe ka përfunduar në korrik të vitit 2016. Në lidhje me këtë rast janë kryer hetime të përbashkëta në mes të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Serbisë, Bullgarisë, Turqisë dhe Italisë. Hetimet janë bërë në bashkërendim të plotë dhe shkëmbim në kohë reale të informacioneve me organet e zbatimit të ligjit të vendeve të përfshira në këtë hetim.

Bashkëpunimi i ngushtë në mes të autoriteteve të shteteve të lartshënuara ka rezultuar në total me arrestimin e 36 personave dhe me konfiskimin e 26 kg e 630g heroinë, 183 kg e 62 g marihuanë, 1 kg e 800 g kokainë, 53150 euro, 7 automjete, 4 armë dhe prova të tjera materiale.

Në Shqipëri janë arrestuar 12 persona (tre kanë qenë në kërkim) dhe janë konfiskuar 16 kg e 6 g heroinë, 5 kg e 162 g marihuanë, 1.5 milionë lekë, 20 000 euro, 7 automjete dhe prova të tjera materiale (telefona, karta bankare etj.).

Në Kosovë janë arrestuar 5 persona.

Në Greqi janë arrestuar 10 shtetas (10 kanë qenë të shpallur në kërkim) dhe janë konfiskuar 7 kg e 262 g heroinë, 1 kg e 800 g kokainë, 7 kg e 900g marihuanë, 33150 euro, 4 armë të ndryshme.

Në Maqedoni janë arrestuar 5 shtetas (7 kanë qenë nën hetim) dhe janë konfiskuar 1 kg e 300 g heroinë dhe 170 kg marihuanë.

Në Bullgari është arrestuar një shtetas dhe janë konfiskuar 2 kg e 62 g heroinë.

“PORTA” mbështetur nga projekti IPA, në bashkëpunim me shtetet: Shqipëri, Serbi, Zvicër dhe Itali jep rezultate konkrete

Rasti i koduar “PORTA” është mbështetur nga projekti IPA dhe është realizuar në bashkëpunim me shtetet: Shqipëri, Serbi, Zvicër dhe Itali ku kanë qenë të përfshirë 91 persona. Lidhur me rastin janë mbajtur 12 takime operacionale (në Tiranë, Shkup, Vjenë, Zagreb dhe Milano) nga takimi i parë më 15 dhe 16 korrik 2015 deri më 6 dhe 7 nëntor 2016.

Bashkëpunimi ka rezultuar në total me arrestimin e 91 personave dhe me konfiskimin e provave materiale: 140 kg e 494 g marihuanë, 55 kg e 60 g heroinë, 60 kg prekursorë (përzierës), 200 000 franga zvicerane, 10 vetura, 1 armë dhe prova të tjera materiale.

Në Kosovë janë arrestuar 7 persona dhe janë konfiskuar 125 kg e 279 gramë, 8 automjete, 1 armë dhe 19 telefona mobilë.

Po ashtu edhe në vendet tjera si: Serbi, Zvicër, Itali ka pasur arrestime dhe sekuestre.

Në Itali janë arrestuar 4 persona dhe janë konfiskuar 11 kg marihuanë dhe 1 kg heroinë.

Në Zvicër janë arrestuar 78 persona dhe janë konfiskuar 27 kg heroinë, 60 kg droga të tjera (sintetike dhe përzierës) dhe 200 000 franga zvicerane.

Në Serbi janë arrestuar 2 persona dhe janë konfiskuar 4 kg e 215 gramë marihuanë dhe 2 automjete.

“LETRA”

Rasti i koduar “LETRA” është iniciuar në vitin 2015, ndërsa hetimet kanë vazhduar në vitin 2016 dhe 2017. Në këtë rast bashkëpunim ka pasur me autoritetet e Shqipërisë, Italisë dhe Gjermanisë. Janë shkëmbyer informata dhe janë mbajtur 3 takime operacionale (2 në Vjenë dhe 1 në Prishtinë). Arrestohen 7 persona dhe konfiskohen 70 kg e 583 g marihuanë. Rasti ka kaluar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe bashkëpunimi ndërkombëtar do të vazhdojë.

KOORDINIMI I SUKSESHEM DEA-PK

Rasti i koduar “MËRGIMTARI” ka filluar me shkëmbim të informatave me DEA- Amerikane ndërsa në muajin qershor 2016, Drejtoria për Hetimin e

Narkotikëve ka realizuar dy operacione policore ndaj disa personave që merreshin me veprën penale 'krim i organizuar'. Me datën 18.06.2017 janë konfiskuar 6 armë automatike AK-47. Rasti ka vazhduar edhe me datën 27.06.2017 me ç'rast në parkingun e veturave të një marketi në Klinë janë ndaluar dhe janë arrestuar 4 persona të dyshuar si dhe janë konfiskuar 8 armë automatike AK47, një armë anti tank (zollë).

Rasti ka rezultuar me arrestimin e 10 personave (4 persona në Republikën e Kosovës dhe 6 persona janë arrestuar në New York) dhe konfiskimin e 15 armëve automatike AK 47, 1 granatahedhës, 1 revole, 1 pushkë gjuetie, 120 fishekë cal. 7.62, 2 vetura dhe 63 000 euro.

"RB"

Rasti i iniciuar "RB" është iniciuar në gusht 2016. Ky rast ka të bëjë me vendosjen e pajisjeve SKIMMING në bankomat me qëllim vjedhjen e të dhënave të kartelave bankare. Pasi që dyshohej se kemi të bëjmë me shtetas të huaj që kanë kryer këtë vepër, me qëllim të shkëmbimit të informatave, përmes ILECU iu është bërë kërkesë të gjitha shteteve për ofrimin e të dhënave në lidhje me rastin.

Pas identifikimit të personit të dyshuar, shtetas i Bullgarisë, me datën 11.11.2016 është bërë kallëzim penal kundër personit të lartcekur dhe është dërguar në Prokurorinë Themelore në Ferizaj. Takimet operacionale janë realizuar në: Aeroportin e Cyrihut (Zyrih), Aeroportin e Frankfurtit, Aeroportin e Vjenës, në Bad Erlach të Austrisë, në Prishtinë dhe në Pragë të Republikës Çeke. Në këto takime është diskutuar për realizimin e "Joint action days" (ditëve të veprimit të përbashkët) dhe rezultatet e arritura pas operacioneve. Në takime operacionale përveç tri shteteve partnere të projektit (Austria, Republika e Kosovës dhe Çekia) në të shumtën e rasteve kanë qenë pjesëmarrëse edhe përfaqësuesit e: Zvicrës, Gjermanisë, Spanjës, Portugalisë, Suedisë, Shqipërisë (takimi në Prishtinë), Rusisë (takimi i fundit), Kolumbisë (takimi i fundit në Pragë), Belgjikës (takimi i fundit) dhe

përfaqësuesit e EUROPOL-it.

Janë organizuar 5 operacione të përbashkëta në nivel ndërkombëtar. Operacionet janë realizuar në kohë reale dhe shkëmbimi i informacioneve dhe bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar ka qenë shumë i mirë. Në Republikën e Kosovës plani është realizuar në Aeroportin Ndërkombëtar (dy operacione) dhe në pikat kufitare e Vijës së Gjelbër.

Operacionet kanë rezultuar me arrestimin e 7 personave dhe konfiskimin e 20 kg e 379 g marihuanë, 2 armë, 6857 fishekë, 70 g MDMA.

Projekti JIFT Drugs f/arms – (Hetimet e përbashkëta në luftimin e trafikimit të drogës dhe armëve të zjarrit) i udhëhequr nga Austria dhe shtetet partnere Kosova dhe Republika Çeke, ka filluar në dhjetor 2016 dhe përfundon në dhjetor 2018.

Qëllimi i projekti është organizimi i operacioneve në kohë reale në aeroporte dhe në pika kufitare në vendet e BE-së dhe në shtetet tjera ku dyshohet se kalon droga. Deri më tani janë realizuar 5 operacione të përbashkëta (joint action days) dhe 10 takime operacionale. Nga udhëheqësit e projektit është vlerësuar lart angazhimi i Policisë së Kosovës, lidhur me bashkëpunimin dhe realizimin e obligimeve që dalin nga plani i veprimit të këtij projekti.

DISA OPERACIONE NDËRKOMBËTARE KU KOSOVA MORI PJESË

Operacioni BEAGLE
Operacioni KABADASHI
Operacioni BOSPOR
JAD 2016 –
JAD 2017

EMPACT Project-Illegal Immigration, Kosovo, Sllovakia, Austria, Macedonia, Slovenia, Croatia, EUROPOL (SOC-AP Migrant Smuggling)
Operacioni GALAXY
Operacioni TRIGGER II
Operacioni POLO- Bashkëpunim në mes të Kosovës dhe Maqedonisë për kontrabandë me mallra (tekstile) dhe duhan.
Operacioni TARGAT.

RASTE TJERA NË NIVEL VENDI "MERKURI"

Rasti "Merkuri" i iniciuar me 08.06.2016 ndërsa operacioni është realizuar me 09.06. 2016, ku janë kontrolluar 10 lokacione të lojërave të fatit, për të cilat dyshohej se janë duke u kryer aktivitete kriminale të veprave 'organizimi i skemave piramidale' dhe 'shmangia nga tatimi'. Gjatë këtij operacioni janë arrestuar 2 persona të dyshuar dhe janë sekuestruar 25 aparate të lojërave të fatit, katër kompjuterë, 1800 euro, si dhe janë mbyllur 10 lokale të lojërave të fatit.

Me datën 29.09.2016 është zhvilluar një operacion policor në rajonin e Prishtinës me ç'rast janë kontrolluar 9 lokacione të dyshuara. Me këtë rast janë sekuestruar: 56 aparate të lojërave të fatit, katër kompjuterë PC, 3080 euro, si dhe janë mbyllur 7 lokale të lojërave të fatit.

Me datën 18.10.2016 është realizuar një operacion policor në rajonet e Prizrenit dhe Gjakovës, me ç'rast janë kontrolluar dymbëdhjetë lokacione të ndryshme në të cilat ishin zhvilluar aktivitete të paligjshme me lojëra të fatit. Operacioni ka rezultuar me sekuestrimin e: 62 aparateve të lojërave të fatit, 7 shtëpiza kompjuterë PC, 4754.50 €, euro, si dhe 11 lokale të lojërave të fatit janë mbyllur nga ana e ATK-së. Lidhur me rastin janë intervistuar 2 persona të dyshuar.

Me datën 15.12.2016 është ndërmarrë një operacion policor në rajonet e Prishtinës, Gjilanit dhe Ferizajt, me ç'rast janë kontrolluar 12 lokacione të ndryshme në të cilat ishin zhvilluar aktivitete të paligjshme me lojëra të fatit. Gjatë operacionit janë sekuestruar: 80 aparate të lojërave të fatit, rreth 40.000 €, 4 shtëpiza kompjuteri si dhe 10 lokale të lojërave të fatit janë mbyllur nga ana e ATK-së.

Të gjitha operacionet janë zhvilluar në bashkëpunim me doganat, ATK-në dhe inspektoratin komunal.

"YJET"

Rast i koduar "Yjet" është iniciuar me datën 09.03.2018 nën dyshimin për kontrabandë me mallra dhe shmangie nga tarifat e detyrueshme doganore. Lidhur me rastin është kontrolluar një

lokacion janë intervistuar dy persona dhe janë sekuestruar: 81 lloje të aparateve (dyshohet të padoganuara), 8 armë të kalibrave të ndryshëm, 33 fishekë të kalibrave të ndryshëm, 1 llap top, 1 palë dylbi, 1 veturë, 59 monitorë të aparateve të lojërave të fatit, 12 akseptorë të aparateve dhe 36 pjesë të ndryshme të aparateve.

RASTI I KODUAR "HANA"

Është iniciuar nën dyshimin për mundësim apo detyrim në prostitucion dhe krim i organizuar. Operacioni është realizuar në muajin mars 2017 me ç'rast janë arrestuar 7 persona (1 mashkull kosovar dhe 6 femra me nënshtetësi të Serbisë), ndërsa kallëzim penal është ngritur ndaj 9 personave. Gjatë realizimit të këtij plani janë konfiskuar telefona dhe para.

Rreth këtij rasti është kërkuar bashkëpunim edhe me shtetin e Serbisë përmes ILECU.

Rasti i koduar "Dubai" nën dyshimet për trafikim me njerëz është iniciuar me datën 04.03.2016. Lidhur me këtë rast janë identifikuar 2 viktimat të trafikimit dhe janë arrestuar dy persona të dyshuar. Po ashtu operacioni ka vazhduar me kontrollimin e 1 lokali (zyre punësimi në Prishtinë) dhe në cilësi të provave materiale janë sekuestruar: kompjuter, telefona dhe dokumente tjera të nevojshme për rastin. Me vendim të gjykatës lokali-zyra është mbyllur me datën 16.03.2016. Gjithashtu, me qëllim të shkëmbimit të informatave përmes ILECU i kemi dërguar kërkesë edhe Dubai.

DISA RASTE KUNDËR KORRUPSIONIT TË PROFILIT TË LARTË

-RASTI I KODUAR "KODRA" është iniciuar për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar. Lidhur me rastin kanë qenë 3 persona të dyshuar (1 kryetar komune, 2 zyrtarë komunalë), ndaj të cilëve është ngritur kallëzimi penal por me 31.05.2016 Prokuroria e ka hedhur poshtë.

-RASTI I KODUAR "IMPORTI" është iniciuar për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar. Lidhur me rastin kanë qenë 3 persona të dyshuar (1 kryetar

komune, 2 zyrtarë komunalë), ndaj të cilëve kanë pushuar hetimet me datën 23.05.2016.

-RASTI I KODUAR "KANALI" është iniciuar për krimi të organizuar, keqpërdorim të detyrës zyrtare, marrje e ryshfeti. Lidhur me rastin janë të dyshuar 4 persona (ish drejtori i një agjencie dhe zyrtar tjerë te agjencisë).

-RASTI I KODUAR "DONACIONI" është iniciuar për shpërdorim të detyrës zyrtare, marrje të ryshfeti. Lidhur me rastin kanë qenë 7 persona të dyshuar (1 ish kryetar i komunës, 1 deputet i Kuvendit të Kosovës, 3 biznesmen, 1 trupor dhe 1 qytetar), ndaj të cilëve rasti është mbyllur në gusht 2016.

-RASTI I KODUAR "PROKURIMI" është iniciuar për shpërdorim të detyrës zyrtare. Lidhur me rastin janë të dyshuar 5 persona (1 kryetar komune, 1 menaxher prokurimi, 1 zyrtarë prokurimi, 2 biznesmenë).

-RASTI: "KEQPËRDORIM I POZITËS APO AUTORITETIT ZYRTAR"/, LËSHIMI I ÇEQEVE PAMBULESË OSETËR REMEDHE KEQPËRDORIM I KARTELAVE BANKARE OSE KREDIT KARTELËS SË BANKËS DHE "PËRVETËSIM NË DETYRË"- Me datën 05.07.2017 është marrë informatë nën dyshimin e arsyeshëm se një nga zëvendësministrat në Qeverinë e Kosovës ka tërhequr para nga bankomati pa mbulesë, duke keqpërdorur kartelën bankare ose kredit kartelën e bankës, me ç'rast ka përvetësuar në detyrë. I dyshuari ka tërhequr shuma parash dhe ka kryer pagesa të ndryshme me kredit kartelën e bankës, pa mbuluar dhe pa arsyetuar me fatura, ku shuma e tërhequr e parave është rreth 14,362.97 €. Është ngritur kallëzimi penal ndaj të dyshuarit.

-RASTI I KODUAR "GJINI 2" është iniciuar nën dyshimin për: shpërdorim të detyrës zyrtare dhe marrje ryshfeti. Dyshimi është ngritur lidhur me ndarjen se subvencioneve bujqësore për fermerët për vitet 2009, 2010 dhe 2011 në shumën rreth 600,000.00 euro në njërin nga komunat e Kosovës. Të dyshuar janë 8 persona (1 ish kryetar komune tani ministër, një drejtor i drejtorisë së bujqësisë, 5 zyrtarë të komunës dhe një pronar biznesi). Aktakuza është ngritur kundër 6 personave.

-RASTI I KODUAR "PROKURIMI" është iniciuar nën dyshimin për: shpërdorim të detyrës zyrtare, marrje e ryshfeti. Keqpërdorimet dyshohet se janë bërë me rastin e dhënies së 20 tenderëve të organizuar nga autoriteti kontraktues në një komunë të Kosovës. Të dyshuar 3 persona (një kryetar komune, një menaxher i prokurimit, një zyrtar i prokurimit).

-RASTI I KODUAR "PHARMACIA" është iniciuar nën dyshimin për: shpërdorim i detyrës zyrtare, dhënie e ryshfeti dhe marrje e ryshfeti. Të dyshuar janë doktorët e punësuar në institucione publike shëndetësore, të cilët kanë pranuar mjete financiare nga kompanitë e ndryshme farmaceutike në këmbim të përshkrimit të barnave të tyre. Lidhur me rastin ndaj 91 personave është ngritur kallëzim penal.

- RASTI I KODUAR "ENERGJIA" është iniciuar nën dyshimin për: shpërdorim i detyrës zyrtare dhe legalizim i përmbajtjes së pavërtetë. Janë të dyshuar 3 persona (1 kryetar komune dhe 2 zyrtarë të tjerë).

RASTI I HETIMIT KUNDËR TERRORIZMIT

Policia e Kosovës në bashkëpunim me institucionet tjera të sigurisë si dhe institucionet e sigurisë të vendeve të rajonit (Shqipëri dhe Maqedoni) në nëntortë vitet 2016 ka arritur që me sukses të parandalojë një sulm të planifikuar terrorist, që kishte për synim të realizojë sulmin gjatë ndeshjes futbolistike Shqipëri – Izrael. Lidhur me këtë rast ka pasur koordinim të plotë, fillimisht përmes shkëmbimit të informacioneve rreth personave të dyshuar nga të tri vendet, si dhe koordinimin e aktiviteteve për ndërmarrjen e operacioneve në kohë të njëjtë në të tri vendet. Gjatë operacionit nga Policia e Kosovës janë arrestuar gjithsej 19 persona të dyshuar, përfshirë këtu 18 shtetas të Kosovës dhe një shtetas të Maqedonisë. Policia e Kosovës, gjithashtu kanë asistuar Policinë Shqiptare me zyrtar në rroba civile, me qëllim të identifikimit të mundshëm dhe monitorimit të personave nga Kosova, që mund të ishin prezentë gjatë ndeshjes futbolistike Shqipëri – Izrael.



SHËNOHET 19 VJETORI I THEME

Me 6 shtator 2018, Policia e Kosovës, në sallën e kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, me ceremoni solemne ka shënuar përvjetorin e 19-të themelimit të saj. Në këtë ceremoni solemne morën pjesë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës si: presidenti i vendit z. Hashim THAÇI, kryeministri i RKS-së z. Ramush HARADINAJ, ministri i Punëve të Brendshme z. Bejtush GASHI, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë, ambasadorë, përfaqësues të misionëve diplomatike, zyrtarë të policisë si dhe familjarë të ftuar të zyrtarëve policorë. Këtë përvjetor me prezencën e tyre

e kanë nderuar edhe drejtorët/zëvendës drejtorët e policive të vendeve të ndryshme të botës, si nga: Shqipëria, Turqia, Maqedonia, Mali i Zi, Guinea Bisao, Kosta Rika, Bregu i Fildishtë, Panamaja dhe Senegali, të cilët ishin mysafirë nderi të Policisë së Kosovës.

Gjatë shënimit të kësaj ngjarje të rëndësishme lidhur me të arriturat dhe rezultatet e Policisë së Kosovës dhe sfidat e përgjithshme që ka pasur ky institucion gjatë viteve të zhvillimit dhe profesionalizimit, fjalimin hyrës e mbajti drejtori i Përgjithshëm i Policisë z. Rashit QALAJ, ndërsa nga një fjalë rasti mbajtën presidenti i Republikës së Kosovës, kryeministri i RKS-së dhe

ministri i Punëve të Brendshme. Drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. QALAJ në një pjesë të fjalimit të tij tha: "Jemi krenarë me parimet me të cilat udhëhiqet PK-ja: trajtimi i barabartë dhe i drejtë për të gjithë, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet politike, integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik, transparenca, legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti. Policia ka trajtuar me prioritet parandalimin e aksidenteve në trafik dhe shtimin e sigurisë në rrugë, ngritjen e sigurisë afër shkollave, parandalimin dhe luftimin e narkotikëve. Janë ndërmarrë aktivitete në





FLIMITTË POLICISË SË KOSOVËS

parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve ekonomike dhe korrupsionit, luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe forcimin e kontrollit të kufijve.

Jemi duke punuar ngushtë me autoritetet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë drejt anëtarësimit në mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë si INTERPOL-it dhe EUROPOL-it. Ne po zhvillohemi komfor nevojave dhe sfidave të brendshme dhe globale. Ne, në asnjë moment nuk do t'i harrojmë 19 zyrtarët policorë të cilët dhanë jetën e tyre në krye të detyrës. Ne kemi mision të shenjtë, të ofrojmë siguri për qytetarët pa dallim. Ne e duam punën tonë, e duam vendin tonë dhe këtë mision të jashtëzakonshëm".

Kurse presidenti THAÇI gjatë fjalimit të tij ndër të tjera tha: "Policia e Kosovës që nga ditët e para e posaçërisht pas pavarësisë së Kosovës është bërë shtylla e parë e shtetndërtimit, institucioni më i besueshëm dhe më i respektuar në Republikën e Kosovës. Raportet ndërkombëtare e vendosin Policinë e Kosovës lart nga krahasim me policinë e rajonit. Ju i keni dhënë Kosovës edhe hero, si Enver Zymberaj



dhe të tjerë".

Ndërsa kryeministri z. HARADINAJ potencoi: "Themelet e jetës sonë të re në Kosovë kemi filluar t'i vendosim të gjithë së bashku. Një themel i rëndësishëm i jetës sonë të re është Policia e Kosovës, e cila është e të gjithëve dhe është krijuar me ndihmën e të gjithëve", tha ndër të tjera kryeministri Haradinaj.

Ministri i Punëve të Brendshme z. GASHI, gjatë fjalimit të tij përgëzoi Policinë e Kosovës për punën, angazhimin dhe përkushtimin në realizimin

e detyrave dhe përgjegjësi të saja karshi vendit dhe qytetarëve, si dhe njëkohësisht shfrytëzoi rastin për t'ia uruar z. QALAJ emërimin në pozitën e drejtorit të Përgjithshëm të PK-së.

Pjesë e rëndësishme e kësaj ceremonie ishte gradimi i gjashtëdhjetë e gjashtë (66) zyrtarëve policorë prej tyre 5 nënkolonelë, 4 majorë, 57 kapitenë, si dhe ndarja e 28 medaljeve prej tyre 1 për shpëtim jete, 9 për shërbim të daluar, 18 medalje policore për lëvdim, e po ashtu janë ndarë edhe 26 lëvdata dhe 22 mirënjohje.

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT KIBERNETIK

Të gjithë tani më jemi të pajtimit që interneti ka depërtuar në të gjitha portet e jetës sonë. Interneti sot është pjesë e përditshmërisë pothuajse e të gjitha shtresave të shoqërisë, shërbime të ndryshme janë të orientuara kah interneti. Sa i përket përdorimit të internetit në Kosovë, numri i përdoruesve në raport me numrin e popullsisë është mjaft i lartë. Natyrisht se i ka të mirat e veta, por, si i tillë që është ai bart në vete edhe rreziqe. Përdorimi në rritje i teknologjisë dhe internetit në të gjitha aspektet e jetës së përditshme, i vë qytetarët në rrezik për t'u bërë shënjestra të krimit kibernetik. Viktima të krimit kibernetik mund të jenë të gjitha shtresat e shoqërisë, pasojat në shumë raste mund të jenë mjaft të mëdha si në aspektin psikologjik, fizik por edhe në aspektin material. Si raste të zakonshme që mund të pësojnë viktimat nga krimi kibernetik janë: vjedhja e të dhënave të ndryshme, shkatërrimi i të dhënave, ngacimi në internet (cyber-bullying), materialet abuzive seksuale me fëmijë në internet, vjedhja e identitetit, kanosjet, shantazhet etj. Dëmet që shkaktohen nga krimi kibernetik shpeshherë janë të parikuperueshme.

Në ditët e sotme pothuajse çdo vepër penale, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte, preket apo mundësohet të kryhet përmes sistemeve kompjuterike.

Marrë parasysh mënyrën e kryerjes si dhe mjetet dhe njohuritë që përdoren për ta kryer, krimi kibernetik është mjaft kompleks, si i tillë edhe hetimin dhe zbulimin e bën më të vështirë. Zbatuesit e ligjit, e posaqërisht hetuesit policorë, duhet të kenë njohuri të larta të teknologjisë informative në mënyrë që të identifikojnë më lehtë keqbërësit apo personat e dyshuar.

Policia e Kosovës në kuadër të ndërtimit të kapaciteteve të saja, për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik ka themeluar Sektorin për Hetimin e Krimeve Kibernetike. Themelimi i këtij mekanizmi ka qenë mëse i nevojshëm, përveç tjerash, edhe për faktin se kriminaliteti po merr formë të re si dhe rrethanat e reja të krijuara.

Sektori për Hetimin e Krimeve Kibernetike është funksionalizuar në shtator 2011, është i strukturuar në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar. Me qëllim të ngritjes së efikasitetit, është bërë ristrukturimi, respektivisht profilizimi, ku në kuadër të sektorit janë formuar katër njësi:

- Njësia për Hetimin e Ndërhyrjeve në Sistemet Kompjuterike;
- Njësia për Hetimin e Keqpërdorimit të Kartelave Bankare;
- Njësia për Hetimin e Pornografisë së Fëmijëve në Internet;
- Njësia për Kontroll dhe Forenzikë të Teknologjisë Informative;

Legjislacioni

Janë një sërë ligjesh dhe dokumentesh në të cilat bazohet puna e Sektorit për Hetimin e Krimeve Kibernetike, ato janë:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
 - Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;
 - Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik, edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së Budapestit për Krime Kibernetike, Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik është punuar bazuar në këtë konventë. Meqenëse ka kaluar një kohë që nga miratimi (Qershor 2010), aktualisht ky ligj është duke u rishikuar;
 - Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale;
 - Ligji për komunikime elektronike etj.
- Vlen të theksohet se, si Kodi Penal i Republikës së Kosovës e po ashtu edhe Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimeve kibernetike nuk e njohin krimin kibernetik si një vepër penale të vetme, por, janë disa vepra që hyjnë në krimet kibernetike.

Rastet

Natyrë e rasteve me të cilat ballafaqohet Sektori për hetimin e krimeve kibernetike mund të them se janë pothuajse raste të "zakonshme" me të cilat ballafaqohen mekanizmat e vendeve tjera për luftimin e krimeve kibernetike, ato janë:

- Keqpërdorimi i fëmijëve përmes internetit (materialet abuzive seksuale

me fëmijë në internet) – këtu hyn shkarkimi, posedimi dhe shpërndarja e materialeve me përmbajtje seksuale të fëmijëve;

- Kanosje dhe shantazhe përmes e-mail-it dhe llogarive në rrjete sociale (përfshirë edhe ndaj personaliteteve të rëndësishme publike dhe institucioneve);

- Cenim i të drejtave të autorit – publikime në internet të punës së tjetrit pa autorizim;

- Hyrje e paautorizuar në sistem kompjuterik (sulme DDoS apo pengim i funksionimit normal dhe ofrimit të shërbimeve në internet ndaj ueb-faqeve të institucioneve të ndryshme publike dhe kompani biznesi, vjedhje e fjalëkalimeve përmes infektimit me viruse kompjuterike, RANSOMWARE etj.);

- Klonimi i kartelave – blerjet online dhe në POS (markete të ndryshme) – vjedhja e të dhënave bankare dhe furnizimi me të dhëna bankare të vjedhura, përdorimi i këtyre të dhënave për klonim të kartelave bankare dhe më pas blerja e gjësendeve të ndryshme nëpër markete përmes POS terminaleve por edhe blerja të gjësendeve përmes internetit;

- Vjedhja e të dhënave të kartelave bankare dhe të kreditit si dhe vjedhja e parave nga bankomatët (vendosja e SKIMMING pajisjeve dhe pajisjeve tjera të modifikuara);

- Mashttrim përmes falsifikimit të e-mail-ave (modifikim i faturave dhe ndryshim i xhirollogarive bankare) si dhe mashttime në internet përmes ofrimit të shërbimeve të ndryshme;

- Gjithashtu ka edhe kërkesa nga shtetet tjera të cilat kanë të bëjnë me raste të ndryshme të krimeve kibernetike e që janë kryer duke përdorur infrastrukturën e Kosovës, si: sulme ndaj ueb-faqeve, përfitim pasuror i paautorizuar përmes shfrytëzimit të shërbimeve që ofrojnë kompani të ndryshme përmes ueb-faqes, përdorimi i kartelave të kreditit në mënyrë të paautorizuar (vjedhje e identitetit) etj.

Trendi i krimit

Nëse i referohemi statistikave të viteve paraprake, vërehet qartë se ka rritje të hovshme të numrit të rasteve që bien

në fushën e krimeve kibernetike. Kjo mund të shihet nga dy këndvështrime: -vetëdijesimi i qytetarëve përkëzistimin e një mekanizmi që lufton krimet kibernetike dhe raportimi i rasteve; si dhe

-angazhimi i shtuar i hetuesve policor në luftimin e krimeve kibernetike. Kjo nënkupton edhe avancimin e njohurive përmes trajnimeve.

Me qëllim që të jemi sa më efikas dhe efektiv në parandalimin dhe luftimin e krimeve kibernetike, janë marrë masa konkrete në këtë drejtim:

-është bërë profilizimi i sektorit duke e ndarë në njësi specifike;

-rritja e numrit të hetuesve policorë;

-identifikimi i nevojave të trajnimit dhe ndjekja e trajnimeve;

-identifikimi i pajisjeve dhe programeve adekuate;

-përgatitja e materialit për krimet kibernetike dhe ligjërimi drejtuar kadetëve, hetuesve policorë të stacioneve, rajoneve dhe drejtorive;

-ligjërata nëpër shkolla me qëllim vetëdijesimin e nxënësve për rreziqet që vijnë nga përdorimi jo i drejtë i internetit.

Bashkëpunimi ndërinstytucional

Bashkëpunimi me institucione vendore është i kënaqshëm. Ndër institucionet vendore, përveç drejtorive të ndryshme të Policisë, bashkëpunojmë me prokurorinë, gjykatat, ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP), institucionet financiare, Doganën si dhe institucione tjera varësisht prej nevojave që paraqiten. Bashkëpunimi i ngushtë në mes të institucioneve relevante është kusht kyç që krimi kibernetik të parandalohet dhe të luftohet në mënyrë efikase dhe efektive. Këtë synojmë ta arrijmë përmes aktiviteteve dhe angazhimeve të përbashkëta, siç janë takimet e ndryshme, trajnimet e përbashkëta etj.

Prej funksionalizimit të sektorit, kemi asistuar në shumë raste të cilat janë hetuar nga njësitë të ndryshme policore dhe mekanizma tjerë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, mund të vlerësojmë si pozitiv por me synim avancimin e tij. Siç dihet, interneti ofron një terren të përshtatshëm për keqbërësit që

të kryejnë një krim nga një vend në vendin tjetër. Nevojitet një bashkëpunim i ngushtë në mes të autoriteteve policore të shteteve në mënyrë që të veprohet shpejt posa të kemi një informacion për kryerjen e një vepre penale. Sektori për Hetimin e Krimeve Kibernetike ka pasur disa raste ku është bashkëpunuar, respektivisht janë zhvilluar hetime të përbashkëta me shtete të ndryshme. Në bazë të përvojës, bashkëpunimi i ngushtë dhe besimi i ndërsjellë janë faktorë kyç për suksesin apo mosesuksesin në hetim dhe në arrestim të të dyshuarve.

Sfidat/Objektivat

Luftimi dhe parandalimi i krimit kibernetik është mjaft sfidues nëse nuk merren masa adekuate për t'u ballafaquar me të. Sfidat konsiderohen: •Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve; Punimi i programeve të trajnimit në fushën e krimeve kibernetike. Këto trajnime duhet të ndjekin nga personeli nëpër institucione publike por edhe private, sepse lufta kundër krimit kibernetik kërkon bashkëpunim të ngushtë në mes të institucioneve publike dhe atyre private.

Meqenëse përgatitja profesionale dhe e specializuar merr kohë të gjatë, synojmë që të bëhet kategorizimi i trajnimit i cili mund të ndahet në bazik dhe të specializuar. Në trajnimin bazik duhet të trajnohen personeli i cili nuk merret drejtpërdrejt me hetimin e krimit kibernetik ose merren me ato vepra që mund të trajtohen edhe në nivele më të ulëta kurse në trajnimin e specializuar duhet të trajnohet personeli i cili merret drejtpërdrejt me hetimin e krimit kibernetik.

•Ndërtimi dhe forcimi i bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar;

Synojmë të avancojmë bashkëpunimin kombëtar, ku kjo mund të arrihet përmes aktiviteteve të ndryshme të përbashkëta (takime, trajnime etj.).

Kurse, sa i përket avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar kontribut do të japë themelimi i Pikës së Kontaktit 24/7, realizimi i hetimeve të përbashkëta etj.

Gjithashtu, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të zbatuesve të ligjit siç janë INTERPOL, EUROPOL etj., ndihmon shumë në shkëmbimin e informatave shpejt dhe në kohë reale, gjë që ndikon drejtpërdrejt në zbulimin e krimit në përgjithësi dhe krimit kibernetik në veçanti.

•Vetëdijesimi dhe edukimi i përdoruesve të internetit;

Statistikat tregojnë se numri i përdoruesve të internetit në Kosovë është shumë i lartë, ky është një indikacion se është më se i nevojshëm vetëdijesimi i qytetarëve apo përdoruesve të internetit. Kjo mund të arrihet përmes fushatave të ndryshme, konferencave, broshurave, shfaqjes së videove nëpër televizione, bisedave me fëmijë nëpër shkolla etj.

Këshilla për përdorim të sigurt të internetit:

- Për t'u shmangur "peshkimit", kurrë mos iu përgjigj e-mail mesazheve që kërkojnë informata personale. Kompanitë serioze kurrë nuk kërkojnë fjalëkalimet apo informata të ndjeshme në këtë formë, apo nuk përdorin fraza "URGJENT" në e-mail. Sido që të jetë, nëse keni ndonjë dyshim se e-mail-i i panjohur mund të jetë keqbërës, në kuptimin e infektimit të kompjuterit, atëherë duhet të kontaktohet zyrtari i TIK-ut;

-Mos kliko në linqe që vijnë nga e-mail-at e dyshimta;

-Mos iu beso ofertave që janë shumë të mira për të qenë të vërteta;

-Kujdes çfarë postoni në internet, ajo çfarë postohet mund të qëndrojë përgjithmonë në internet;

-Nëse iu vjen ndonjë e-mail e dyshimtë (p.sh. nuk pritni diçka të tillë) nga ndonjë koleg apo shok, kontakto kolegun apo shokun për verifikim të e-mailit;

-Kurrë mos ua bëj "Forward" e-mail-ave të cilët supozohet se janë të infektuar;

-Privatësia në vend të punës ka tjetër kuptim dhe nuk ka asgjë të bëjë me privatësinë tuaj personale apo me privatësinë e publikut të përgjithshëm;

-Social engineering (inxhinieria sociale);

-Gjithmonë navigo ose shfleto në ueb-faqe duke e shtypur vetë ueb-adresën, mos kliko në ndonjë link që të dërgon në ato uebfaqe. Sigurohu që ueb faqet që kërkojnë informata të ndjeshme janë të enkriptuara, shiko për HTTPS në shfletuesin tuaj.

Përgatiti:

Kapiten Fadil Abdyli

Shef i Sektorit për Hetimin e Krimeve Kibernetike – DHKO



ROLI I ZYRËS SË MEDIAVE NË POLICINË E KOSOVËS

Zyra e Shtypit, ose siç njihet në opinion Zyra e Mediave, është njëra ndër zyrat më me rëndësi brenda një institucioni. Kjo zyrë është kanali numër një i pasqyrimin të punëve dhe të aktiviteteve në opinionin e gjerë. Është shtylla bazë e cila ia mban rrënjët e forta një shtëpie të madhe. Ajo mbjell dashamirësi, tregon besim, mban përgjegjësi, jep shpresë, jeton dhe ballafaqohet me “thashetheme”, mbijeton nga presionet dhe tundimet, rrizgjuardhe është gjithnjë e gatshmetë përgjigjet për çfarëdolloj informacioni që i shkon në mendje dikujt të pyesë. Zyra e Mediave e Policisë së Kosovës kështu punon çdo ditë. Kjo zyrë përbëhet nga një major, që është edhe shefi i zyrës, një kapiten, një toger, një rreshter-uebmaster dhe 4 zyrtarë të stafit civil, ku njëri është dizajneri, fotografi-IT multimedia, lektorja dhe zyrtarja e lartë për analizë të shtypit dhe të mediave.

Ky ekip funksionon dhe bashkëpunon mirë. Në këtë zyrë ka dinamikë, punë me prioritete, përgjegjësi të mëdha e limite kohore.

Në këtë vend duhet patjetër të mbash veten me durim, me vetëpërmbytje dhe gjithsesi të jesh i gatshëm dhe i përgatitur në çdo kohë të përballesh me publikun e gjerë. Zyrtari për informim detyrimisht duhet t'i dijë të gjitha rreth organizatës, të mbajë kontakte miqësore edhe atëherë kur nuk i ka për zemër, të mbajë lidhje me shumë njerëz të profileve të ndryshme, të jetë

gjithnjë i gatshëm dhe t'i përgjigjet hierarkisë e gjithsesi se duhet të jetë ai që di ta shprehë se organizata të cilën e përfaqëson e bën punën më së miri, është më e realizuara, duke shfletuar rezultatet konkrete.

Një zyrtar mediash është një arkivë në vete, ai është plot me informacione nga shumë fusha, por shumë i përmbajtur në shpërndarje, gjithnjë i matur dhe i saktë në interpretime. Informacionet që dalin për publikun duhet të jenë të kuptueshme e të qarta, ngase si audiencë mund të ketë njerëz të shtresave nga më të ndryshmet, siç është p.sh. një bujk, një punëtor krahu, një i ri/ e re, një i moshuar dhe secili prej tyre të jetë në gjendje ta kuptojë mesazhin e asaj që thuhet. Nëpërmes kësaj zyre shpërndahen raportet ditore, si 24-orëshi, raporti i shtypit ditor, përgatiten informacionet, përpilohen përgjigjet e dhjetëra kërkesave në ditë, jepen prononcime, përpilohen fjalime, pjesëmarrje nëpër debate ku prezantohet puna policore, tregohen rezultatet e aksioneve policore, bëhen aktivitete të ndryshme, fushata parandaluese, pastaj pranojmë edhe shumë kërkesa për çështje studimore, kërkesa për përkrahje dhe lejim nëpër xhirime filmash, videospote televizive, përgatiten tekste mirënjohjesh, tekste falënderimesh, pranojmë edhe kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

Një zyrtar mediash duhet të dijë të flasë rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me tonalitet, të flasë bindshëm dhe të jetë

njeri i besueshëm. Një zyrtar mediash ka shoqëri gati të pandarë me telefonin, ai është lehtësimi dhe vështirësimi i përditshmërisë së tij në një ditë pune e gjithsesi edhe shoqërimi i tij edhe në jetën private.

Zyrtari për informim ka shumë sfida në lidhje me realizimin e familjes dhe të jetës private. Ai është 24 orë zyrtar mediash, gjë që lë pak vend të jetë një familjar aktiv. Roli i Zyrës së Mediave në Policinë e Kosovës është i patjetërsueshëm, nëpërmes kësaj zyre krijohet imazhi i një policie të tërë, këtu është pasqyra e të gjitha zhvillimeve. Falë punës së palodhshme të zyrtarëve policorë, si dhe paraqitjes së rezultateve në opinionin e gjerë publik nga kjo zyrë dhe nga zyrat e tjera rajonale Policia e Kosovës gëzon besueshmëri të lartë, duke u bazuar në disa sondazhe të fundit. Investimi në një zyrë mediash sjell rezultate qenësore në mbrojtjen e imazhit të institucionit dhe njëkohësisht e krijojnë një shtyllë mbrojtëse, sjell një rehati për menaxhmentin dhe për të gjithë zyrtarët brenda organizatës. Prandaj, ndaj Zyrës së Mediave duhet të mbajmë qasje korrekte, lidhje të sinqerta dhe bashkëpunim të mirë, sepse kjo e bën më të lehtë punën e kësaj zyre.

Përgatiti:
Merita Canolli-Gashi
Zyrtare e lartë për analizë
të shtypit dhe mediave

GJËNDRA TIROIDE DHE ROLI I SAJ NË ORGANIZËM

(Dallimi në mes të rënies dhe rritjes së funksionit të gjëndrës tiroide)

Gjëndra tiroide është gjëndër endokrine, e cila gjendet në mes të laringut dhe trakesë. Roli kryesor i gjëndrës tiroide qëndron në sekretimin e hormoneve të T3 (Trijodtironinës) dhe T4 (Tiroxinës).

Funksioni sekretues i hormoneve të gjëndrës tiroide është i rregulluar me mekanizmin e ashtuquajtur FEED-Back; Sekretimin e tireotropinës (TSH-së), hipofizave dhe kontrollimin intratiroidik të metabolizmit të jodit.

Tireotropina (TSH) është hormon glikoproteinik i pjesës së përparme të hipofizës, i cili rregullon rritjen dhe funksionin e tireociteve (nga të cilat pastaj prodhohen hormonet e tiroides T3 dhe T4 me rëndësi të madhe për rritje dhe metabolizmin e organizmit).

Niveli i TSH-së në gjak ndryshon varësisht nga nevojat e organizmit për hormonet e gjëndrës tiroide.

Dallimet në mes të rritjes dhe uljes së funksionit të gjëndrës tiroide janë të shprehura në vazhdim:

Hipertireodizmi

Shkaktohet nga sekretimi i shtuar i hormoneve të gjëndrës tiroidiene T3, T4, çdo rritje e T3, T4 shkakton ulje të tireotropinës (TSH-së).


Sëmundja Basedov (Morbus Graves); Hipertireoza është sëmundje që shkaktohet nga stimulimi i vazhdueshëm i receptorëve të TSH-së nga antikorpet IgG. Sëmundja mund të shfaqet pas një stresi psikofizik.

Shenjat e kësaj sëmundjeje janë: struma, ekzoftalmus (dalje e syrit jashtë orbitës), Tahikardia (të rrahura të shpejtuara të zemrës), tremori (dridhje e duarve) rënie në peshë,

rritje e metabolizmit bazal.

Për të saktësuar diagnozën duhet ndjekur ekzaminimet diagnostifikuese, si: ekografi me Doppler, scintigrafia e tiroides, antikorpet duhet kërkuar për të kuptuar natyrën autoimmune të sëmundjes.

Komplikimet e sëmundjes. Mund të jenë kardiake (të zemrës), muskulore (ku mund të preket edhe zona faring-laringale me çrregullime të gëlltitjes), kockore (që mund të çojë deri në osteoporozë).



Mjekimi i sëmundjes Basedov me tretmanin simptomatik, me pushim fizik dhe psikik, sedative, beta-blokatorët dhe tretmani specifik; Antitiroidienet e sintezës dhe në rast të krizave kërkohen urgjenca mjekësore. Hipotiroidizmi. Shkaktohet nga ulja e nivelit të hormoneve Tiroidiene (Trijodtironina dhe Tetrajodtironina), si pasojë e frenimit të funksionit të gjëndrës tiroide.

Shkaqet janë të shumta dhe mund të

lidhen me vetë dëmtimet e gjëndrës tiroide të shoqëruar ose jo me strumë, si pasojë e dëmtimeve në nivel të hipofizës dhe hipotalamusit. Dëmtimi autoimun, dëmtimi viral, Thyroidectomy etj.

Për dallim nga rritja e funksionit të gjëndrës tiroide këtu kemi rritje të koncentrimin të TSH-së.

Pra, TSH bazal i rritur është shenjë e Hypotireozës (uljes së funksionit të gjëndrës tiroide).

Shenjat e sëmundjes: ulje të metabolizmit (ulje të konsumimit të oksigjenit), ulje të temperaturës qendrore, ngadalësim të katabolizmit të lipideve (duke shkaktuar hiperkolesterolemi), opstipacion (kapsllëku), bradikardi (të rrahura të ngadalësuara të zemrës).

Lëkura e thatë, ënjtje të kapakëve të syve, fytyrë e fryrë, trashje e zërit, flokët janë të thatë dhe bien me intensitet më të shtuar, thonjtë janë me strie dhe rriten më ngadalë, pastaj shfaqet edhe ngadalësim psikomotor (çrregullim të kujtesës, sindroma depresive) etj. Mjekimi: Më e preferuara është L-Thyroxina (me rekomandim të endokrinologut).

Këshilla: Të përpiqemi për një jetë cilësore, duke përfshirë: ushqimin e shëndetshëm, përdorimin e kripës se jodizuar, përdorimin e prodhimeve të detit, aktivitetin fizik, gjumë të mjaftueshëm (duke përjashtuar ndërrimet e natës në punë që e pamundëson gjumin), evitimin dhe menaxhimin e duhur të situatave të stresit, mospirjen e duhanit etj.

Dr. Lindita Kajtazi
Interniste-Endokrinologe

OPERACIONE

DISA NGA OPERACIONET E SUKSESSHME

Arrestohen 31 (tridhjetë e një) persona të dyshuar për 'marrje me prostitucion'

Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ), me datën 13 shtator 2018, mbështetur në hetimet paraprake, ka realizuar një operacion policor, i cili ka rezultuar me arrestimin e 31 personave të dyshuar.

Personat e dyshuar janë arrestuar nën dyshimin për kryerjen e veprës penale 'marrje me prostitucion, Neni 7, Ligji 03/L-124, të cilët dyshohet se me veprimet e tyre i kanë përmbushur elementet e kësaj vepre.

Personat e arrestuar në këtë rast janë gjithsej 31 (tridhjetë e një), nga të cilët 2 (dy) femra shqiptare kosovare dhe 29 (njëzet e nëntë) meshkuj shqiptarë kosovarë.

Me këtë rast është bërë edhe identifikimi i katër personave të tjerë, të cilët dyshohet se momentalisht nuk gjenden në Kosovë, por do të paraqiten personalisht në Gjykatë.

Pas konsultimit me Gjykatën Themelore të Departamentit për Kundërvajtje në Prishtinë ndaj të gjithë të dyshuarve është iniciuar kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje, ku me datën 13 shtator 2018 ata janë dërguar me procedurë të shpejtë pranë organeve të drejtësisë, respektivisht në Gjykatën Themelore – Departamenti për Kundërvajtje në Prishtinë.



Arrestohen gjashtëmbëdhjetë (16) persona nën dyshimin e bazuar për përfshirje në trafikim të armëve

Me 29 gusht 2018, Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit, ka zhvilluar hetime intensive, me qëllim të zbardhjes së veprimtarisë kriminale të disa të dyshuarve që merreshin me kryerjen e veprave penale të trafikimit të armëve.

Duke u bazuar në urdhëresën e gjykatës kompetente, më 29.08.2018 në rajonin e Prishtinës (në katër lokacione), atë të Gjilanit (në dy lokacione) dhe Ferizajt (gjashtëmbëdhjetë lokacione), është zhvilluar operacioni policor i koduar me emrin "SYRI", i cili ka rezultuar me arrestimin gjashtëmbëdhjetë (16) personave të dyshuar për trafikim me armë. Njësitë policore në njëzet e dy lokacione, kanë kryer kontrole të shtëpive dhe objekteve përcjellëse, pronë e të dyshuarve me qëllim të mbledhjes së provave për veprimtarinë kriminale të të dyshuarve. Gjatë këtij operacioni policor janë sekuestruar provat materiale:

- 19000 euro para kesh,
- 3 armë të gjata,
- 17 armë të shkurta kalibri i ndryshëm,
- 2850 fishekë kalibër të ndryshëm,
- 20 karikatorë,
- 1 pasaportë bullgare,
- 3 telefona,
- dokumente tjera që vlejné për procedurë të mëtejme gjyqësore.



Personat e dyshuar, në bazë të vendimit të prokurorit dërgohen në mbajtje.

Policia mbetet e përkushtuar në realizimin e detyrave të saja kushtetuese e ligjore për të ofruar rend dhe siguri publike, luftuar aktivitetet kriminale, përfshirë edhe trafikimin e armëve.

Policia, në tri rajone të ndryshme, arreston shtatëmbëdhjetë të dyshuar për përfshirje në veprimtari penale

Me 29 gusht 2018, Policia, konkretisht Njësia për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (NJHTQNj) Prishtinë, pas një hetimi paraprak, me datën 28.08.2018 ka zbatuar një plan taktik ku ka arrestuar 14 (katërmëdhjetë) të dyshuar. Tre (dy femra dhe një mashkull) të dyshuar, janë arrestuar për përfshirje në veprat penale: 'mundësim ose detyrim në prostitucion' dhe 'ofrim i lokaleve për prostitucion', kurse 11 (njëmbëdhjetë) të dyshuar të tjerë, për 'marrje me prostitucion'. Lidhur me rastin është njoftuar prokurorja kujdestare, me aktvendim të saj, të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt.

Po ashtu, me 28.08.2018 NJHTQNj-Ferizaj, pas një hetimi të bërë ka arrestuar një të dyshuar për përfshirje në veprën penale 'mundësim dhe detyrim në prostitucion'. Në konsultim me prokurorin e rastit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, i dyshuari lirohet ndërsa lënda shkon në procedurë të rregullt.

Më 28.08.2018, NJHTQNj-Gjilan, ka arrestuar dy persona të dyshuar, për shkak të dyshimit të bazuar për 'marrje me prostitucion'. Personat e arrestuar, pas kompletimit të rastit janë dërguar me procedurë të shpejtë në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Policia mbetet e përkushtuar në realizimin e detyrave të saja kushtetuese e ligjore për të ofruar rend dhe siguri publike, luftuar aktivitetet kriminale, përfshirë trafikimin me qenie njerëzore.

Operacioni policor i zhvilluar në Gjilan dhe në Gjakovë ka rezultuar me arrestimin e tre personave të dyshuar dhe konfiskimin e mbi nëntëmbëdhjetë kilogramëve substancë narkotike

Me 7 gusht 2018, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, ka zhvilluar operacione në Gjilan dhe në Gjakovë, me qëllim luftimin e trafikimit me narkotikë.

Operacioni policor në rajonin e Gjilanit, është realizuar konkretisht në fshatin Novosellë të komunës së

Kamenicës, i cili ka rezultuar me sekuestrimin e një sasi prej 19.370 gramë substancë e dyshuar narkotike si dhe me arrestimin e dy të dyshuarve:

I. R. dhe A. R, meshkuj shqiptarë.

Të dyshuarit janë arrestuar pasi të njëjtit janë zënë në flagrancë duke e shkarkuar një sasi të substancës narkotike nga vetura 'Golf 5', të cilën e posedonin të dyshuarit.

Lidhur me rastin është njoftuar prokurori i Shtetit dhe gjyqtari i procedurës paraprake me urdhër të të cilëve është kontrolluar edhe shtëpia e të dyshuarve të lartcekur, ku gjatë kontrollit në podrumin e shtëpisë u janë gjetur edhe dy paketime me substancë narkotike të llojit marihuanë.

Ndërsa në rajonin e Gjakovës, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë gjatë operacionit të përbashkët ka realizuar një bastisje e cila ka rezultuar me sekuestrimin e një arme dhe disa fishekë.

I dyshuari L. A. mashkull shqiptar është arrestuar dhe është ndalur në qendrën e paraburgimit në Gjakovë.

Gjatë operacionit të përbashkët, në cilësi të provave materiale janë sekuestruar:

- 19.370 gramë substancë e dyshuar narkotike
- vetura 'Golf 5'
- një armë 'AK-47'
- 24 fishekë,
- një peshore elektronike
- një telefon 'Samsung'

Veprimet e ndërmarra nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve kanë qenë në koordinim me prokurorët e Shtetit në Gjilan dhe në Gjakovë, me aktvendim të të cilëve të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.



Integriteti, bazë e një pune të suksesshme

Ngritja e një organizate policore me integritet lidhet me integritetin që kanë individualisht secili nga punonjësit e saj dhe organizata në përgjithësi. Kur përmendet integriteti individual kjo nënkupton se organizata policore duhet të rekrutojë, të trajnojë staf me integritet, në mënyrë që secili nga punonjësit të ndikojë në krijimin dhe fuqizimin e integritetit të organizatës. Sikurse që individët veç e veç ndikojnë në integritetin e organizatës edhe organizata ndikon në integritetin individual të punonjësve të saj e kjo bëhet përmes mekanizmave të krijuar nga vetë organizata.

Mekanizma këto që shërbejnë për të udhëhequr punonjësit drejt sjelljeve me integritet dhe mbrojtjen e organizatës nga cenueshmëritë dhe rreziqet e cenimit të integritetit organizativ. Këto dy segmente: integriteti individual dhe integriteti organizativ janë bazamenti për të krijuar një organizatë policore me integritet.

Një prej prioritetëve që Policia e Kosovës i ka kushtuar që nga themelimi i saj ka qenë formimi i një force policore me integritet në shërbim të qytetarëve të Kosovës pa dallim, duke e pasur integritetin si një nga vlerat më të larta të punës policore në organizatën tonë policore.

Integriteti i organizatës pasqyrohet nga performanca e punonjësve të organizatës, prandaj është e domosdoshme se qysh në fazën e rekrutimit të stafit të bëhen përpjekje maksimale për të rekrutuar staf me integritet.

Nëpër vite në parime dhe procedura të punës policore kanë ekzistuar rregullat e sjelljes etike dhe me integritet por duke parë standardet ndërkombëtare lidhur me trajtimin e çështjeve të integritetit në organizatat policore. Edhe Policia e Kosovës vite më parë ka filluar të identifikojë praktikatat e zbatimit të planeve të integritetit dhe si rrjedhojë e kësaj në mars vitit 2017 është themeluar grupi për hartimin e planit për fuqizimin e integritetit në



Policinë e Kosovës.

Duke u bazuar në dokumentet e brendshme policore por edhe me mbështetjen e partnereve ndërkombëtarë është punuar "Plani për fuqizimin e integritetit në Policinë e Kosovës për periudhën 2018-2019". Ky dokument është aprovuar nga drejtori i Përgjithshëm dhe është duke u zbatuar nga 1 janari 2018.

Plani në vetvete synon të ngritë vëmendjen e të gjithë punonjësve të Policisë për trajtimin me seriozitet dhe profesionalizëm të problemeve, të cilat mund të dëmtojnë imazhin, reputacionin dhe integritetin e organizatës tonë policore.

Ky dokument ka edhe planin e veprimit, ku janë të paraqitura: lista e cenueshmërive të identifikuar dhe të vlerësuara të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të Policisë dhe planin e masave për përmirësimin e integritetit, i cili përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të ulur cenueshmëritë e integritetit, si dhe afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative përkatëse të zbatimit.

Me qëllim parandalimin e veprimeve

joetike dhe pa integritet në Policinë e Kosovës në plan janë paraparë një numër i madh i aktiviteteve, si shtimi i aktiviteteve nga mekanizmat e kontrollit, duke filluar nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë e deri tek inspektimi dhe auditimi.

Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit jashtë dhe brenda organizatës është parakusht për një organizatë me integritet, prandaj takimet me stafin ku do të flitet hapur për këtë fushë por edhe për temat që cenojnë integritetin si dhe trajnimet si në nivel lokal dhe qendror do të jenë aktivitete parandaluese. Rishikimi i udhëzimeve dhe procedurave standarde të punës është një nga fushat ku kërkohet të ndërhyhet, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në punë.

Transparenca dhe komunikimi me publikun është një nga fushat që ndikon në rritjen e integritetit dhe imazhit të organizatës. Transparenca sidomos në fushën e rekrutimit, promovimit në menaxhimin e kontratave, financat dhe prokurimit janë veprime të cilat ndikojnë në ngritjen e integritetit të organizatës tonë policore dhe mbrojnë organizatën nga cenueshmëritë si nga jashtë dhe nga brenda.

Plani për fuqizimin e integritetit ka për qëllim që të ndikojë tek secili punonjës i Policisë që me performancën e tyre ta forcojnë integritetin e organizatës. Plani nuk promovon veprime ndëshkuese për punonjësit, por rekomandon veprime të cilat parandalojnë që punonjësit të përfshihen në veprime që bien ndesh me disiplinë apo me vepra tjera.

Është e domosdoshme që secili nga punonjësit e veçanërisht mbikëqyrësit të përqendrohet në implementimin sa më të mirë të këtij plani, në mënyrë që bashkërisht të rrisim integritetin dhe imazhin e organizatës tonë policore.

Major Brahim Sadriu
Zyrtar përgjegjës për implementimin e planit për fuqizimin e integritetit

POLICIA E KOSOVËS PËRMES FAQES ZYRTARE UA MUNDËSON QYTETARËVE QASJEN PËR KONTROLLIMIN E TIKETAVE TË TRAFIKUT

Me 9 korrik 2018, referuar kërkesave të shumta dhe prezencës së shtuar të qytetarëve nëpër stacione policore, për t'u informuar lidhur me numrin e kundërvajtjeve/gjobave të papaguara që mund t'i posedojnë, Policia e Kosovës ka lansuar ueb-modulin e publikuar në ueb faqen zyrtare të PK-së (www.kosovopolic.com).

Me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi Policia e Kosovës, përmes mekanizmave

të brendshëm, ka ofruar një mundësi që tikitat e papaguara të mund të kontrollohen, duke u qasur në ueb-faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, pa pasur nevojë të paraqitjes nëpër stacione policore. Lansimi i këtij ueb-moduli si fazë testuese ka filluar me datën 06.07.2018, në ueb faqen e PK-së, ku është instaluar ikona "Gjobat në trafik" (sikurse në foton më poshtë), ku pas klikimit në të njëjtën dhe ofrimin e të dhënave si (numri per-

sonal, emri dhe mbiemri), çdo qytetar do të ketë mundësi t'i gjejë sa tika të papaguara i ka, numrin e tikitës, në cilin stacion janë shqiptuar dhe sa e kanë vlerën. Vlen të theksohet se në mungesë të një sistemi të unifikuar të të gjitha institucioneve të përfshira në këtë proces që përfshijnë: shqiptimin e gjobave nga PK-ja, ndëshkimet/vendimet nga organet e drejtësisë dhe pagesat që realizohen përmes autoriteteve bankare, ekziston mundësia e shfaqjes së

ndonjë mosevidentimi të pag-

esave në kohë optimale, të re-

alizuar nga qytetarët.

Policia e Kosovës është duke

punuar në vazhdimësi në kual-

itetin e shërbimeve, përfshirë

këtu edhe rifreskimin e të dhë-

nave në rastet kur qytetarët i

ofrojnë dëshmitë mbi pagesën

e gjobave, me qëllim të shly-

erjes së tyre nga sistemi.

Ndërsa sa i përket shqetësimit

rreth mbrojtjes së të dhënave

personale ueb moduli për kont-

rollin e gjobave në trafik është

në përputhje të plotë me ligjin

për mbrojtjen e të dhënave

personale, si dhe të gjitha të

dhënat që shfaqen janë të en-

kriptuara sipas standardeve për

enkriptimin e të dhënave.



Kontrollo gjobat e trafikut

Numri personal:

Email:

Mbiemri:

Data e lindjes (dd/mm/yyyy):

Shkruani kodin nga imazhi:

Pajtohem

Bazuar në nenin 54 të Ligjit Nr.03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale jap pëlqimin për përpunimin e ligshëm të të dhënave të mia personale.

Kontrollo gjobat e trafikut

Linqe	Statistikat e përgjithshme: 30.10.2018		Revista zyrtare
Gjobat në trafik	Aksidente fatale	0	
Raporto krimin	Aksidente me të lënduar	18	
Raporto krimin kibernetik	Aksidente pa të lënduar	30	
Personat në Kërkim	Tiketa trafiku të shqiptuara	1219	
Fushatë vetëdijesimi	Arrestime	13	
Dokumentet strategjike	Në mbajtje	8	

KURIOZITETE



Kjo është shpikja më e mirë për policët

Në të shumtën e rasteve Policia e ka shumë të vështirë kapjen e personave të cilët ngasin shumë shpejt veturat e tyre.

Mirëpo, si duket tashmë i ka ardhur fundi kësaj.

Në rrjetet sociale është duke qarkulluar një video, ku një person ka shpikur mënyrën se si të ndalohen personat që i kërkon policia apo edhe ata që ngasin shpejt veturën.

Përmes kësaj shpikje, tani e tutje policia do ta ketë shumë më lehtë.

Shpresojmë që shumë shpejt një pajisje e tillë ta ketë edhe Policia e Kosovës.


Polici pret fëmijën që kërcen nga kati i tretë

Një polic egjiptian gjatë patrullimit para një banke i ka shpëtuar jetën një djaloshi të vogël për shkak të shpejtësisë së tij. Pesëvjeçari Ammar Motaz Abd El-Salam ishte me familjen e tij në një ndejë në qytetin Asyut kur ai ra nga dritarja e katit të tretë.

Fatmirësisht për të, polici Kameel Fathy Greed, 45-vjeçar, u gjend në vendin e duhur në kohën e duhur.

Kamera e sigurisë ka kapur momentin kur ai me dy kolegë të tjerë vërejnë djalin në dritare dhe kërkojnë të gjejnë gjëra për pritjen e tij.

Teksa dy policët përpiqeshin të marrin një tepih për të pritur më lehtë djalin, ai kërcëu por u prit me sukses nga polici dhe arriti të shpëtonte.



Ky është vendi më i sigurt për t'u ulur në avion

Edhe pse kur arrini në destinacion pasi keni udhëtuar me avion doni ta falënderoni me zemër shpikësin e avionit që ju dhuroi këtë komoditet, jo gjithçka është kaq e lehtë sepse sidoqoftë jeni duke udhëtuar në ajër dhe mos të harrojmë se ka shumë njerëz që e kanë fobi avionin vetëm për këtë.

Ekspertët e avionëve flasin se ka disa sekrete të vogla që mund t'i merrni në konsideratë në mënyrë që të keni një udhëtim sa më të kënaqshëm.

Nëse ka vende të rezervuara në avion mos mendoni që janë gjithmonë komode sepse në përgjithësi këto vende janë për persona që mund të kenë probleme shëndetësore ose për bebe të cilat qajnë përgjatë gjithë kohës që fluturon. Kështu që mund të ndodhë që vendi se mendoni se do t'ju sjellë më tepër komoditet të jetë vendi më i pakënaqshëm.

Ekspertët rekomandojnë që të uleni në fund të avionit, sidomos në udhëtime të gjata sepse do të keni shërbim më të mirë të asistentëve të stafit, të cilët aty qëndrojnë...



Sa km i mbesin makinës tuaj pasi ndizet llampa e kuqe? Lista sipas markave më të përdorura

Ndezja e llambës spiune që tregon se karburanti po mbaron është padyshim pjesë e eksperiencës së shoferit. Makina të tregon se ka ardhur koha për ta furnizuar dhe të detyron të ndalosh në pikën më të afërt të karburantit.

Modelet më të reja, madje dhe disa nga të vjetrat kanë paketa elektronike që përllëgarisin se sa kilometra mund të përshkosh. Por nëse je në një rrugë të gjatë, është thelbësore të dish se sa rrugë i ka mbetur makinës.

Të bësh një përllëgaritje ekzakte është shumë e vështirë: duhet të llogarisësh 1/10 e serbatorit dhe ta pjesëtosh me sa litra për 100 km bën makina, në varësi të llojit të rrugës, motit, trafikut dhe gjendjes së mjetit.

Portali Tank on Empty është një databazë të dhënash ku çdo shofer mund të japë pikërisht llojin e informacionit që kërkon. Secili përcakton se sa kilometra rrugë ka makina e tij para se të ndalojë dhe portali nxjerr një mesatare për çdo model.

Sipas të dhënave të kësaj databaze, SCAN ka bërë një klasifikim për disa nga automjetet më të shpeshta në Shqipëri duke nisur nga modeli me më shumë kilometra.


Modeli kilometra të përshkuara me karburantin rezervë:

Audi Q7 96 km
Mercedes A-Class 86 km
Volkswagen Pasat 78.3 km
Peugeot 206 77.3 km
BMW X5 77.2 km

Renault Megane 77.1 km
Mercedes C-Class 74 km
Opel Astra 72.4 km
Renault Scenic 71.7 km
Mini Cooper 71.6 km
Volkswagen Golf 69.5 km
Smart 69 km
Ford Focus 66.8 km
Volkswagen Polo 67.9 km
Mercedes E-Class 67 km
Toyota Yaris 65.9 km
Audi A3 65.3 km
Range Rover 65 km
Ford Fusion 64.72 km
Ford Fiesta 62 km
Fiat Punto 52.4 km
Jeep Grand Cherokee 50.5 km
Opel Corsa 49.7 km.

Policja heroinë, e gjeti foshnjën duke vdekur nga uria në pyll, e ushqen me gji

Një ditë, një grua kishte shkuar për një shëtitje në pyll për të mbledhur fruta, kur në një moment dëgjoji një zhurmë që vinte nga shkurret. Ajo dukej si britma e një fëmije shumë të vogël dhe në fakt kështu rezultoi. Aty ishte braktisur një foshnje. Për fat të keq, fëmija ishte braktisur nga nëna e saj menjëherë pas lindjes. Gruaja menjëherë thirri policinë dhe, në një kohë të shkurtër, policja Luisa Fernanda Urrea arriti në vendin e ngjarjes. Në fillim i ngjau si britma e një maceje, por kur u afrua u trondit nga ajo që pa, ajo ishte një foshnje e porsalindur, e cila ende kishte kordoni e kërthizës bashkangjitur, dhe nga mënyra e vajit dukej se ishte duke vdekur nga uria. Policja Urrea ishte bërë kohët e fundit nënë dhe, me këtë rast, ka bërë një gjest që preku mijëra njerëz në mbarë botën. Një gjest i thjeshtë, heroik dhe vetëmohues me të cilin ajo shpëtoi një jetë. Gruaja, që nga fillimi, e kuptoi se situata ishte shumë e rëndë dhe, në sajë të instiktit të nënës, vendosi të bëjë diçka menjëherë. Madje nuk hezitoi as edhe për një moment.



E gjen makinën e huaj hapur por nuk do ta besoni çfarë vjedh

Ndonjëherë dashuria e madhe për diçka, të shtyn të bësh veprime jo fort të hijshme. I tillë është ky rast, ku një person ka parë diçka që i ka tërhequr vëmendjen brenda një makine, brenda së cilës nuk ndodhej askush.

Është pikërisht një çokollatë Kit-Kat ajo që ka shtyrë djalin të provojë nëse makina ishte e hapur dhe ta marrë çokollatën.

Gjithsesi, ai ka menduar t'i lërë një shënim Hunter Jobbins nga Kansas i SHBA-ve, të cilit i shkruan:

"E pashë këtë Kit-Kat në mbajtësen e gotës. E dua shumë këtë çokollatë dhe e provova derën nuk ishte e mbyllur. Nuk kam marrë asgjë tjetër pos kësaj. Të kërkoj falje, isha i uritur".

Ndërsa, një nga komentet pas publikimit të këtij rasti ishte: "Do ta bëja edhe unë të njëjtën gjë".

Përgatiti: Çajup KAJTAZI



KOLONEL TAIBE CANOLLI-BRAJSHORI, SHPËRBLEHET ME ÇMIMIN E PARË NDËRKOMBËTAR TË LIDERSHIPIT 'IAWP'



Kolonel Taibe Canolli-Brajshori, në vitin 2000, u bë një nga femrat e para që iu bashkua Policisë së Kosovës, pas përfundimit të konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë.

Ajo ka punuar shumë për të arritur pozitën e saj aktuale, si drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Policisë së Kosovës. Koloneli i parë femër i Policisë së Kosovës, Taibe Canolli-Brajshori,

është shpërblyer me çmimin ndërkombëtar të Liderit të 'IAWP', në Kanada.

Ky çmim iu jepet policëve që dallohen me të arriturat e tyre të vazhdueshme në liderit, në zgjidhjen e problemeve, planifikimit, organizimit, komunikimit, të cilët japin një kontribut të rëndësishëm brenda agjencisë ose misionit për zbatimin e ligjit.

NËNKOLONEL FLORIE HAJRA, DREJTOR I DREJTORISË SË TEKNIKËS KRIMINALISTIKE KA DIPLOMUAR NË AKADEMINË NACIONALE TË FBI-SË



Nenkolonel Florie Hajra, drejtor i Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike, Departamenti për Hetime, ka diplomuar në Akademinë Nacionale të FBI-së, Sesioni 272, në Quantico, Virginia, SHBA. Ky ka qenë një trajnim 10 javor për liderit dhe menaxhment në fushën e zbatimit të ligjit. Prej gjithësejt 232 pjesëmarrësve, vetëm 25 pjesëmarrës kanë qenë ndërkombëtarë, në mesin e të cilëve edhe përfaqësuesja nga Policia e Kosovës, nenkolonel Florie Hajra.



Ekipi i Policisë së Kosovës në futboll është shpallur kampion në turneun ndërkombëtar në Poreç, të Kroacisë!

Turneu ka filluar nga data 17 shtator, ku kanë marrë pjesë 17 shtete nga e gjithë bota dhe ekipi i PK-së edhe përmes aktiviteteve sportive ka treguar vlerat dhe angazhimet e saja duke arritur rezultate pozitive.